

# PËRMBAJTJA


7 Lutja ime për një Universitet...


10 Intervistë me Masar Krasniqin


14 Vetëvrasjet, sfidë për gjithë...


30 Fati i një studenti


32 Vdiq Imam-Hafëz Zihni Ahmedi


Portreti i muajit: Agjëroni që t'i kuptoni myslimanët .. 2
Editoriali ... 3
**Osman D. Gashi:** Nis punën qeveria e re ... 4
**Gëzim Qerimi:** Papërgjegjësia e Ministrisë së Arsimit .. 5
**Avni Avdiu:** Arsimi i përgjakur ... 6
**Agron Tufa:** Lutja ime për një Universitet të Ri 7-8
**Qendresa Mustafa:** Matura 2009, sukses apo dështim? ... 8-9
Intervistë me Masar Krasniqin ... 10-12
**Fatos Shala:** Fëmijët kryefamiljarë ... 13
**Astrit Veliqi:** Vetëvrasjet, sfidë për gjithë njerëzimin! ... 14-15
Fotolajm ... 15
**Ahmed Zevail – fitues i Çmimit Nobel ... 16-18**
**Arber Zeka:** Aktivitete të shumta të organizatës INTA gjatë muajit Ramazan ... 19
**M. Zejnullahu:** Ramazani pastrim i përgjithshëm për besimtarët ... 20
Ndahen 200 euro për vendin e parë ... 20
**Driton Kurti:** "VESA" – mjaft aktive gjatë Ramazanit ... 21
**Mevlude Zejnullahu:** Mysafirë që ma shtuat imanin ... 22
**Osman D. Gashi:** Ne dhe Evropa ... 23
**Wolfgang Böhm:** Ahitsari: Pranimi i Turqisë në BE nuk bart rreziqe ... 24-25
**Mimoza Sinani:** Prerja e artë – Masa e bukurisë e krijuar nga Zoti ... 26-28
**Halil Asllani:** 'Njeri nuk bon shpin e vet me vjedh' 29
**Iljasa Salihu:** Fati i një studenti ... 30
**Mr. Ejup Haziri:** Përballë vetvetes ... 31
**Hasan Emërllahu:** Vdiq veterani dhe eruditi i Islamit, Imam-Hafëz Zihni ef. Ahmedi ... 32
**Flamur Maloku:** Diferenca e tekstit ... 33
**Astrit Veliqi:** Paradoksi kulturor kosovar ... 34
**Arben Veseli:** Në rrahun e shkretuar ... 35
Poezi ... 35
Aforizma ... 36
**Iliriana Alloqi & Bernard Tahirbegolli:** Angina .. 37
**Alban Bilalli:** Besart Berisha ëndërron të luajë për Kosovën ... 38-39
Refuzon të luaj në Ramazan ... 39
Fjalëkryqi ... 40






REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti IV / Nr. 34
19 shtator - 19 tetor 2009
Botues
Zëri Ynë
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
**Muhamed Jusufi - KAJOLLI**
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
**Avni AVDIU**
avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës
**Flamur MALOKU**
flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
**Osman D. GASHI**
osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore
**Mimoza SINANI**

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:
**Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14, përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë**


Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

## Portreti i muajit

# Agjëroni që t'i kuptoni muslimanët

Sipas të përditshmes 'Daily Mail' prefekti i Londrës Boris Xhonson ka kërkuar që jo-muslimanët ta agjërojnë një ditë të muajit të shenjtë të Ramazanit, për ta ndihmuar kuptimin e fqinjëve të tyre muslimanë. "Kërkoj nga njerëzit veçanërisht gjatë Ramazanit për të mësuar më shumë rreth Islamit", - tha Xhonson gjatë një vizite në xhaminë në Lindje të Londrës dhe në Qendrën Muslimane në Londër. "Shtone kuptimin dhe mësimin rreth Islamit, edhe agjëroni për një ditë bashkë me fqinjët tuaj myslimanë si dhe bëni iftar në xhamitë afër jush". Xhonson tha se një mirëkuptim i Islamit do t'i ndihmonte njerëzit të largoheshin nga idetë negative dhe dallimet në shoqëri. Ai gjithashtu vlerësoi rolin e muslimanëve në sfidimin e "stereotipeve tradicionalë". "Muslimanët janë në teatër, komedi, sport, muzikë e politikë, ata po i sfidojnë stereotipet tradicionalë", - tha ai, duke shtuar se muslimanët po tregojnë se janë dhe dëshirojnë të jenë pjesë e komunitetit të zakonshëm. Një studim i mbikëqyrur nga Qeveria ka zbuluar se grumbujt e tregimeve negative në mediat britanike, i kanë djallëzuar muslimanët dhe fenë e tyre, duke i paraqitur ata si armiq të brendshëm. Muslimanët britanikë, që llogaritet të jenë rreth dy milionë, gjithashtu kanë marrë barrën kryesore të ligjit antiterror pas sulmeve në Londër. Ata janë ankuar vazhdimisht për keqtrajtime të përsëritura nga policia për të vetmen arsye se janë muslimanë. Kryetari i Londrës vlerësoi rolin e muslimanëve britanikë në ndërtimin e shoqërisë britanike në vend. "Muslimanët janë në zemër të çdo aspekti të shoqërisë", - tha ai. "Kontributi i tyre është diçka prej së cilës përfiton çdo londinez. Policët, doktorët, shkencëtarët dhe mësuesit muslimanë janë pjesë




themelore e 'fabrikës Londër'", - tha ai. Xhonson ka shtuar po ashtu se financa islame po kontribuon në ekonomi, duke e ndërruar mënyrën se si londinezët po investojnë, kursejnë, huazojnë dhe harxhojnë. "Ka mësime të vlefshme që njerëzit nga çdo përkatësi mund të mësojnë nga Islami", - tha ai. Kryetari i Londrës mendon se të gjitha praktikat e mira të muslimanëve pasqyrohen në mësimet e Ramazanit, "të tilla siç është rëndësia e bashkësisë, lidhjeve familjare, mëshira dhe ndihmesa për ata në nevojë. Krejt këto qëndrojnë në zemër të mësimeve të Ramazanit", - shtoi ai.

**Kush është Boris Xhonson**

Boris Xhonson ka lindur më 19 qershor 1964 në Nju Jork, SHBA. Është i martuar me Marinën dhe kanë dy djem e dy vajza. Është edukuar në kolegjet Eton (Shkencëtarët e Mbretit) dhe Balliol, Oksford (Studiuesit e Brackenbury-it në kohët e vjetra). Ai punoi në *The Times*, *The Wolverhampton Express* dhe *Star* para se t'i bashkëngjitej *The Daily Telegraph*, ku u shqua si shkrimtar prijetar i suksesshëm i kryeartikujve, korrespodent i BE-së dhe ndihmës redaktor. Më 1997 ai është votuar si *Komentuesi Politik më i Mirë i Vitit* në debatin "Çfarë thonë letrat"; Më 1998 në mënyrë të mistershme përcaktoi Federatën Kombëtare Pagane të Gazetarëve të Britanisë së Madhe; Më 2003 ai u votua si *Redaktori i Vitit*; Më 2004 u votua si *Kolumnisti i Vitit* në ndarjen e çmimeve British Press dhe në dhjetor të 2005-tës në 'Çfarë thonë letrat' u zgjodh si Kolumnisti i Vitit. Ai është votuar si më i miri në çmimin që ka ndarë Channel 4 News për kontribut të madh në politikë gjatë viteve 2004-2005. Ai shkruan kolumnën javore për *The Daily Telegraph*. Ka publikuar gjashtë libra: *Shokët, Votuesit, Fshatarët; Mi huazo veshtë, Shtatëdhjetë e dy të virgjërit, Ëndrra e Romës, A kam pikëpamje për ju, Jeta në Shiritin e Shpejtë: Udhërrëfyesi i Xhonsonit për Veturat dhe Përgjegjësitë e Prindërve Urdhëronjës, Një Rrëfenjë Paralajmëruese*. Më 2 maj 2008, Boris u zgjodh kryetar bashkie i Londrës nga 1,000,000 londinezë.





# Ndihma pas protokollit

Nënshkrimi i Protokollit Euleks-Serbi përshkoi ditët e fundit opinionin kosovar me lloj-lloj debatesh. Protokolli u bë pjesë e debatit të përditshëm. Dhe ç'është për t'u habitur, kjo nuk është hera e parë që shqiptarët duke filluar prej liderëve politikë e gjer te qytetari i thjeshtë zihen në befasi. Në fillim shpërthjenë, vazhdojnë duke u zbutur në qëndrimin e tyre dhe me kalimin e kohës pajtohen me cilindo proces qoftë. Dhe mjafton për palën kosovare fakti se i janë ekspozuar presionit të kombinuar amerikano-evropian, kështu që gjithçka të ketë justifikimin e kapshëm. Një aspekt interesant në këtë linjë është edhe nënshkrimi i dy marrëveshjeve Kosovë-SHBA dhe toneve shpresëdhënëse që përcolli ambasadori amerikan Dell në Prishtinë. Kjo me gjasë sadopak e vuri nën hije ekzagjërimin e mundshëm të çështjes së protokolleve, shpërbeu si një stabilizator për eskalimin e mundshëm të tensioneve dhe ishte një formë ngushëllimi. Situatat e tilla i sjellin në pozita paradoksale edhe politikanët kosovarë. Zaten përderisa ata reaguan me shpejtësi kudrejt nënshkrimit të protokolleve s'kishin as idenë se ç'përmbanin ato. Pastaj gjersa presidenti dhe kryeministri vazhdonin me kundërshtimin e ashpër, kryeparlamentari filloi t'i shfaq shenjat e para të fleksibilitetit. Edhe faktori ndërkombëtar u tregua konfuz. Eurodeputetja Doris Pak vlerësoi se pa nënshkrimin e Kosovës, marrëveshja e protokollit me Serbinë nuk i duhet askujt. Analisti Daniel Server theksoi se institucionet e Kosovës kanë të drejtë ta mbrojnë sovranitetin e shtetit të tyre, aty ku ata mendojnë se ai po shkelet. Ndryshe prej tyre ministri suedez i punëve të jashtme Karl Bild, vendi i të cilit mban presidencën e radhës së Bashkimit Evropian, duke i porositur autoritetet në Prishtinë që ta mbështesin nënshkrimin e protokolleve, siguroi se ato janë në interes afatëgjatë për Kosovën. Kjo diskrepancë në qëndrime, lë hapësirë jo vetëm për dyshime, por shtron edhe dilema tjera, me të cilat duhet të përballemi çdo ditë, ndër të cilat kryesorja, e cila i gjeneron të tjerat është se mbase faktori ndërkombëtar nuk flet me një gjuhë të përbashkët, atëherë çfarë qëndrimi duhet mbajtur ndaj këtij faktori. Në këtë kontekst Vetëvendosja është e prerë. Ata e shohin EULEK-sin si kopje të UNMIK-ut, si vazhdimësi e tij. Mbi njëzet organizata joqeveritare organizuan protestë kundër protokolleve Eulex-Serbi, por nuk pati aq protestues sa kanë mund të kenë pritur organizatorët. Ndonëse Albin Kurti mendon se shkaku i jehonës së vogël është se nuk ka masë kritike për rizgjim shoqëror, megjithatë rrënjët mund të jenë më të thella se supozimet e tij. Thjesht populli është lodhur nga gjithçka: nga politika, nga liderët, nga ndërkombëtarët, nga debatet shterpe, nga premtimet e parealizuara e kështu me radhë. Se çfarë do të rezultojë nga protokollet e nënshkruara mbetet të shihet në kohë dhe për momentin asgjë nuk mund të parathuhet, kur realisht jo vetëm se mungojnë analizat e thukta, por edhe njohuritë se çka nënkuptojnë ato. E tëra çka dihet janë disa deklarata që nuk çuan dhe nuk çojnë peshë assesi. Nga plasimi i ngutshëm i tyre, duhet të merret mësim njëherë e përgjithnjë. E rëndësishme është që në rastet e ngjashme të hartohet një strategji e përbashkët e reagimit jo shpejt e me emocione, por e një reagimi tamam serioz institucional, që do të ishte i denjë për një shtet që aspiron njohje të reja, integrime euroatlantike dhe njohje në OKB. ■

# Nis punën qeveria e re



Osman D. GASHI

Koalicioni Berisha-Meta, që do ta qeverisë Shqipërinë për katër vitet e ardhshme, ka rezultuar me një qeveri interesante për nga formati i saj, me të djathtit e të majtit. Është komentuar shumë se sa e moralshme ka qenë, sa funksionale do të jetë dhe se sa do të zgjasë, por, pa marrë parasysh vlerësimet e ndryshme, vlen të thuhet se kjo qeveri ka gjasa të mëdha dhe për këtë tremben edhe socialistët, se mbarëvajtja e këtij koalicioni do t'ia zgjaste jetën koalicionimeve të ardhshme. Se sa e moralshme ka qenë s'ka koment, mbase qëmoti në hapësirat tona është ndarë morali nga politika, edhe pse parë realisht kjo ka qenë rrugëdalja e vetme nga qorrsokaku për të mos caktuar zgjedhje të reja. Se a do të jetë funksionale, gjasat janë për po, sepse inkuadrimi i Metës me përvojë të kryeministrit dhe me orientim politik ndryshe, do të ishte një tutor i nevojshëm për Berishën dhe partinë e tij. Meta do të ketë kurajë intelektuale ta korrigjojë Berishën, kurse Berisha nuk do të mund të drejtojë krye më vete. Të vetëdijshëm se këmbimi dhe shkëmbimi i përvojave do të jetë në të mirë të qeverisjes afatgjatë, gjë që do të ndikojë e reflektojë kjo edhe në zgjedhjet e ardhme, ata nuk do të hezitojnë ta dëgjojnë njëri-tjetrin, tekefundit për të mirën e tyre. Zaten kësaj i frikohet Edi Rama dhe PS. Andaj bojkoti është njëfarë shprese e beftë për një parapërgatitje për caktimin e zgjedhjeve të parakohshme. Mirëpo blloku antibojkot brenda PS do t'i shtojë gjasat që ideja e Ramës të mos mbesë vetëm e kundërshtuar nga Blushi e Malaj, por edhe nga faktori ndërkombëtar. Pra, gjasat janë që qeverisja Berisha-Meta të jetë ndër qeverisjet më të suksesshme që ka njohur Shqipëria.




**Eksperienca politike e Sali Berishës:**
- -Kryetar i PD-së: 14 shkurt 1991 – 9 prill 1992
- -Deputet i Kuvendit Popullor: 31 mars 1991 – 9 prill 1992
- -President i Republikës së Shqipërisë: 9 prill 1992 – 23 korrik 1997
- -Kryetar i PD-së: 21 tetor 1997 – vazhdon
- -Deputet i Kuvendit të Shqipërisë: 24 korrik 1997 – vazhdon
- -Kryeminister i Republikës së Shqipërisë: 3 shtator 2005

**Kryeministrat e Shqipërisë**
- -Ismail Qemali 1912 – 1914
- -Turhan Pasha 1914
- -Esat Toptani 1914 – 1916
- -Turhan Pasha 1918 – 1920
- -Sulejman Delvina 1920
- -Iljaz Vrioni 1920 – 1921
- -Pandeli Evangjeli 1921
- -Qazim Koculi 1921
- -Hasan Prishtina 1921
- -Idhomeno Kosturi 1921
- -Xhaferr Ypi 1921 – 1922
- -Ahmet Zogu 1922 – 1924
- -Shefqet Vërlaci 1924
- -Iljaz Vrioni 1924
- -Fan Noli 1924
- -Iljaz Vrioni 1924 – 1925
- -Ahmet Zogu 1925 – 1928
- -Kostaq Kotta 1928 – 1930
- -Pandeli Evangjeli 1930 – 1935
- -Mehdi Frashëri 1935 – 1936
- -Kostaq Kotta 1936 – 1939
- -Xhaferr Ypi 1939
- -Shefqet Vërlaci 1939 – 1941
- -Mustafa Kruja 1941 – 1943
- -Ekrem Libohova 1943
- -Maliq Bushati 1943
- -Ekrem Libohova 1943
- -Ibrahim Biçakçiu 1943
- -Rexhep Mitrovica 1943 – 1944
- -Fiqri Dine 1944
- -Ibrahim Biçakçiu 1944
- -Enver Hoxha 1944 – 1954 (3 mandate)
- -Mehmet Shehu 1954 – 1981 (7 mandate)
- -Adil Çarçani 1982 – 1991 (3 mandate)
- -Fatos Nano 1991
- -Ylli Bufi 1991
- -Vilson Ahmeti 1991 – 1992
- -Aleksandër Meksi 1992 – 1997 (dy mandate)
- -Bashkim Fino 1997
- -Fatos Nano 1997 – 1998
- -Pandeli Majko 1998 – 1999
- -Ilir Meta 1999 – 2002
- -Pandeli Majko 2002
- -Fatos Nano 2002 – 2005
- -Sali Berisha 2005



# Papërgjegjësia e Ministrisë së Arsimit



Gëzim QERIMI

Vendimi i agjencisë për mosakreditimin e asnjë universitetit privat si duket do t'i ketë edhe pasojat e veta.

Këtë e themi pasi një vendim i tillë ndikoi negativisht edhe për UP- në, përkatësisht ngarkoi me më shumë studentë Universitetin e Prishtinës, përkundër kapaciteteve shumë të limituara që ka UP-ja.

Në këtë kontekst, Ministria e Arsimit (MASHT) po vazhdon traditën dhjetëvjeçare të pasluftës për ndërhyrje politike në Universitetin e vetëm publik, pa u konsultuar fare me organet e UP-së.

Ministri Hoxhaj, me një vendim të tij, e rriti numrin e studentëve, duke mos e pyetur fare rektoratin e këtij Universiteti, duke mos i interesuar fare për "Lirinë akademike", liri për të cilën ai deklarohet në deklaratat e tij publike.

Paradoksi i këtij vendimi është se Ministri Hoxhaj, me këtë akt të tij, ka treguar se edhe pse është ligjërues në UP nuk posedon as informatat elementare për funksionimin dhe për infrastrukturën që ka Universiteti Publik. A është e njohur për Ministrinë e Arsimit, shembull ta marrim, departamenti i programit fillor i Fakultetit të Edukimit, i cili ka kapacitete për t'i pranuar vetëm 25 studentë, sepse kaq janë kapacitetet infrastrukturore? Por, në afatin e parë, dekanati i Fakultetit të Edukimit ishte bërë shumë zemërgjerë dhe kishte propozuar 35 studentë. Megjithëkëtë, ministri Hoxhaj, për të treguar se ka zemërgjerësi me shumë se gjithë të tjerët, ka vendosur që të ketë konkurs plotësues për pranimin e studentëve të rinj dhe, në kuadër të saj, parashihet edhe rritja e studentëve për 100 % në Fakultetin e Edukimit. Në fund shtrohet pyetja: si është e mundur që të kemi proces mësimor të mirë kur, ta marrim si shembull, programi fillor ka vetëm 20 karrige, ndërsa numri i studentëve për këtë vit është 70? Kjo është puna më banale e këtij procesi, por gjërat më serioze janë se a e ka planifikuar MASHT-i edhe dyfishimin e ligjëruesve e asistentëve, apo ndoshta ka edhe ndonjë strategji tjetër të papërgjegjshme që do ta kuptojmë në ditët e ardhshme. ■



Universiteti i Prishtinës, në vitin e parë të studimeve, në afatin e parë të konkursit, për vitin akademik 2009 - 2010 ka regjistruar 10.380 studentë, prej të cilëve 8.765 studentë të rregullt dhe 1.615 studentë me korrespondencë. Ndërsa në konkursin plotësues do të regjistrojë edhe 8281 studentë.
Universiteti i Prishtinës, në vitin e parë të studimeve, në konkursin plotësues, për vitin akademik 2009-2010 do të regjistrojë 8281 studentë, prej të cilëve 7211 studentë të rregullt dhe 1070 studentë me korrespondencë.
Universiteti do të regjistrojë edhe 439 studentë të rregullt nga Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Presheva, Medvegja, Bujanoci, si dhe 185 studentë nga minoritetet turq, boshnjak, rom, ashkali dhe egjiptian.
Të drejtë pranimi në Universitetin e Prishtinës kanë të gjithë kandidatët të cilët e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
Në Universitet mund të pranohen edhe studentë nga shtetet e tjera, në bazë të kuotave të përcaktuara nga ana e MASHT-it.
Kandidatët jokosovarë dhe minoritarë kanë të drejtë që të konkurrojnë dhe të pranohen vetëm në kuotat e parapara për ta.



# Arsimi i përgjakur



Avni AVDIU

As shtatori i sivjetmë nuk solli përmirësime për shkollimin në gjuhën shqipe në Maqedoni. Fillimi i vitit shkollor u përcoll me pështjellime të mëdha për nxënësit shqiptarë. Problemet janë të natyrave të ndryshme: ose mungojnë hapësira, ose paralele, ose profesorë. Nga ana e saj, Ministria e Arsimit as nuk dëshiron të dëgjojë për këto probleme. Shkaktarë të shumicës së problemeve në arsim janë vetë shqiptarët. Fenomeni i politizimit të arsimit shqip ka kaluar edhe marrëzitë e kohës së monizmit. Arsimtarët e profesorët, në masë të madhe, kanë nisur të punojnë në institucionet e arsimit përmes librezës partiake. Kjo të kujton kohën e tmerrshme të komunizmit, kur libreza e kuqe ka pasur peshë të madhe. Në këtë drejtim është vetëm një dallim: se atëherë ka qenë një parti dhe kush ka pasur librezën e kuqe ka pasur siguri të garantuar (vendim pune). Tani, kur në të shumtën e rasteve inkuadrimi në punë bëhet përmes kontratës, ku ta dijë i shkreti punëtor se cilën parti ta përkrahë. Sa vjen në pushtet njëra, bie tjetra. Pastaj secila parti që vjen në pushtet, i dëbon njerëzit që ka vënë partia tjetër dhe i vë njerëzit e vet. Mund të flitet veç për diferencime dhe hakmarrje politike që do t'ua kishin zili edhe komunistët e kuq me çekan e drapër në zemër.

Në këtë drejtim, asnjë parti politike s'ka të drejtë morale të flasë për politizim të arsimit, kur vetë ajo parti politike e ka politizuar arsimin kur ka qenë në qeveri. Si pasojë e kësaj gjendjeje, që dorën në zemër më së shumti u konvenon maqedonasve, kanë hedhur rrënjë edhe problemet dhe me gjasë ato kanë prirje edhe të eskalojnë. Revanshizmi i largimeve nga puna të shqiptarëve me kontratë në vepër (në Universitetin e Tetovës, shkolla fillore e të mesme të Tetovës, Gostivarit, Shkupit, Kumanovës etj.) ka eskaluar në shkollën fillore "Përparimi" në fshatin Çegran të Gostivarit, ku drejtori i shkollës Shaban Saliu ka plagosur me dy plumba në dorë e këmbë burrin e mësimdhënëses së larguar, Nexhat Isenin. Ky i fundit ka hyrë në zyrën e drejtorit për t'i kërkuar sqarime për përjashtimin e gruas së tij nga puna. Incidentin e ka shoqëruar paraprakisht konflikti verbal mes të dyve, për shkak se drejtori i shkollës ka përjashtuar nga puna bashkëshorten e të plagosurit. Pas shumë skandaleve që i bëjnë vetë partitë shqiptare në raport me arsimin shqip, u desh të ndodhte edhe kjo për t'ua vënë kapakun të gjitha marrëzive që s'po dihet se ku do ta kenë fundin. Kur e kthen kujtesën pak në retrospektivë dhe kujton sakrificat e shumta që janë bërë dikur për arsimin shqip, kur kujton gjakun dhe lotin e derdhur për ta ngritur atë, të rrëqethet trupi kur sheh tash se si 'patriotët' partiakë, fatkeqësisht me gjak shqiptari, luajnë me këtë thesar aq të çmuar të popullit. "Burrat e dheut", nëse ua mban, kanë për çfarë të angazhohen. Ata duhet të preokupohen për qindra probleme të shumta që akoma ekzistojnë në këtë drejtim. Sivjet qeveria ka dalë me konkluzionin që, prej klasës së parë, nxënësit shqiptarë duhet të mësojnë maqedonishten. Shkurtimi i paraleleve në Shkollën e Mjekësisë në Tetovë, nga ana e MASH-it, ka përjashtuar nga regjistrimi mbi 200 nxënës. Shkolla fillore "G. Dellçev" e Manastirit, e vetmja shkollë me paralele me mësim në gjuhën shqipe, prej sivjet do të vazhdojë në gjuhën maqedonase. Gjersa nxënësit shqiptarë në Kumanovë kanë probleme me objektet ku duhet ta zhvillojnë mësimin, nxënësve maqedonas, përveç objekteve të përshtatshme, po u ndërtohen edhe salla sportive nëpër fshatra. Në shkollën e mesme të mjekësisë "Pançe Karagjozov", në Shkup, jo vetëm që s'është hapur paralelja e shumëkërkuar e farmacisë, por është caktuar që edhe në paralelen e laborantëve të kimisë mësimi të zhvillohet në gjuhën maqedonase. Madje nxënësve shqiptarë ua kanë caktuar edhe kujdestarin e klasës maqedonas. Nga një mori problemesh të shumta veçojmë edhe shkurtimin e buxhetit për USHT. Nëse krahasohet me buxhetin e Universiteti i Shtipit, që ka tre mijë studentë, del se këtij universiteti i janë ndarë 80 milionë denarë më shumë se USHT-së, që ka rreth 13 mijë studentë. Pra, këto janë problemet që duhet të angazhohen t'i zgjidhin politikanët shqiptarë, e jo ta qesin një shqiptar nga puna për ta punësuar një tjetër, jo të mbjellin urrejtje ndërshqiptare për interesa të ngushta partiake dhe, nga ana tjetër, të sillen ndaj problemeve reale sikur s'është duke ndodhur asgjë. ■



# Lutja ime për një Universitet të Ri



Agron TUFA

Ah, o Zot, sikur të isha aq i pasur, sa të ngrija një Universitet të Ri!

Ku të mos kishte rektorë, dekanë e shefa që vihen dhe hiqen nga zgjedhjet demokratike të kurdisura nga Lart, ose të sponsorizuara nga Poshtë;

Ku të mos vareshim nga Ministria dhe ministra të mefshtë, nga burokratë idiotë e përtacë, që nuk nxjerrin qimen prej qullit, me mendime e veprime të zëna kaps;

Ku të mos kishte një zhgan të pacipë sekretarësh që nuk flasin, por lehin, që nuk shërbejnë, por pinë kafe e lënë takime me sekserët skutave;

Ku të mos kishte pedagogë, që e kanë ngritur karrierën deri te thinjat, duke sharë, anatemuar fenë, mendimin, shkencën e virtytin e pastër me citatet e Marksit, Leninit, Stalinit dhe Enverit, duke ia bërë naftën Dijes, Profesionit dhe Etikës;

Ku të mos shitej nota me para nën dorë ose me "taksë në natyrë" dhe Dija të jepej e të merrej nisur nga shenjtëria e bashkëpjesëtimit me dashuri, e jo të përçohej me 'kabëll' e instalime të mbrapshta;

Ku figura e mësimdhënësit dhe e studentit të lidhej sipas raportit të lashtë Mjeshtër-Dishepull, e jo Sharlatan-Batakçi;

Ku dhuntia e Dhënies të kalonte nga Koka përmes Zemrës dhe jo nga surretërit e ngrysur përmes shfryrjes dhe bezdisë;

Ku studenti të zgjidhte fakultetin nga kurioziteti, etja dhe dëshira për të ditur, e jo sipas planifikimit banal familjar.

Sikur, o Zot, të isha aq i pasur sa të ngrija një Universitet të tillë, që të mund të fshinte përgjithmonë kujtesën e keqe të të gjitha universiteteve!

Ku të kishte auditore të bollshme, me dritë e ngrohje, qetësi e blerim, e jo bimsa të errëta, akullsi polare ose duhmë të nxehtë ferri;

Ku të respektohej mendimi, puna kreative dhe origjinaliteti i çdo studenti dhe të mos i cenohej askujt shenjtëria e shenjtërive – privatësia;

Ku të funksiononin bollshëm e lirisht të tria shtyllat që e mbajnë në këmbë një Tempull të dijes: Programi më i përparuar i qytetërimit bashkëkohor, Garantuesit e këtij programi (pedagogët) dhe Bibliotekat klasike dhe Online;

Ku studenti të niste një dialog të pandërprerë me pedagogun dhe burimet e literaturës, derisa të dilte nga auditorët përfundimisht Dikushi, me grada shkencore dhe instrumentet e dijes, i projektuar për një ardhmëri, që do të shkurtonte injorancën tonë të gërbulur;

Ku nga Dija studentit t'i hapej "Syri i Tretë" dhe ta peshonte me mendje e zemër mrekullinë e pafund të ekzistencës dhe ta njihte forcën dhe misionin e tij në këtë botë;

Ku truri të ndriçohej jo me profka të mykura, por nga zbulimi i të Vërtetave dhe Thelbeve të fshehura, me qëllim që Dashuria e Brishtësia t'i afrohen të Mirës, që don të jetë dhe të Keqes, që rrudhet nga turpi;

Sikur o Zot, të më jepje aq para, sa të ngre një Universitet Ideal!

Ku pedagogët të zinin vendin e tyre me meritë, sipas punës e dijes së gjallë, e jo me katapulta nga Poshtë e nga Lart, me diploma e tituj të vërtetë e jo të blerë në tregun e Gabit ose në tregun e Refugjatëve;

Ku lodhja të shpërblehej bujarisht dhe jo sipas tekave të kokëqypave të Ministrisë;


Ku të kishin të drejtë të vazhdonin udhën e dijes e lartësimit, sipas dëshirës dhe aftësisë, pa përjashtim të gjithë dhe jo të bëhej monopol kjo e drejtë në duar banale të ca meskinëve dhe filistinëve;

Ku forma të përputhej me përmbajtjen jo vetëm brenda mureve të universitetit, por edhe jashtë, në jetën e madhe;

Ku në provime të shpërblehej me meritën që i takon gjithsecilit, sipas mundit, pa telefonata, ndërhyrje, shantazhe e kërcënime e zënie pusi;

Ku në fund të ciklit, dija të marrë udhën e saj nëpër Atdhe për të ndriçuar të tjerët, e jo të marrë udhë injoranca dhe errësira për të pllakosur terri në çdo cep të vendit tonë;

Ku mendja e syri të kridhen vertikalisht në libër, shkallë-shkallë, e jo të bredhin horizontalisht në sipërfaqen e sheshtë të ekranit ngjyra-ngjyra, duke përtypur pasivisht shijen bajate që dikton cektësia;



Ku brezat tanë të edukohen me faktet, arsyetimet, imagjinatën, dyshimin dhe kundërshtimin e bazuar, jo të marrin pil në thashetheme të fryra rreth filxhanit të kafesë ose bisedave dhe sms-ve me celular;

Ku të rritet vlerësimi objektiv për veta, persona dhe rrethana dhe jo t'i sigurojnë vetes të vetmin botëkuptim gratis: paragjykimin;

Ku njohja të përftohet nga përballja individuale me përvojën objektive dhe subjektive dhe jo nga kurthet e parapërgatitura të imazhit publik, nëpërmjet mediave dhe propagandës demagogjike dhe askush të mos mbetet i gozhduar në kornizën e imazhit që diktojnë mediumet.

Të lutem o Zot, më jep aq para sa të ngre një Universitet Ideal!

Që të harrohen universitetet private të ngritura me para të pista dhe reklama bujëmëdha;

Që të harrohen e të fshihen nga kujtesa universitetet private të ngritura me kredi, nën protektoratin dhe varësinë e ministrave, politikanëve, kryetarëve të bashkive, shoqatave të dyshimta, filialeve ndërkombëtare etj;

Që të harrohet dhe fshihet përgjithnjë dija e shpërndarë pa përgjegjësi e matrapazëve me dosje të falsifikuara dokumentesh;

Që të shuhet e shfaroset fara e dijes majmunore që shpërndajnë çunakët dhe çupat me diploma e grada të mbledhura pupthi nëpër universitetet e shteteve, të cilëve nuk ua dinë as gjuhën;

Që të fshihet njëherë e mirë njolla e turpshme e licencës së universiteteve private, të lëshuar nga ministrat në shkëmbim të një valixheje me euro;

Që të marrë fund në këto universitete era e turpshme e shitjes së diplomave dhe titujve, njëlloj si në Pazarin e Gjizës;

Që të harrohet pa kthim ajo përmbytje e madhe nëpër të gjitha universitetet me literaturë të turpshme, kriminale dhe matrapaze e komunizmit, së bashku me demagogët e djeshëm me thinja, më të dëmshëm se kriminelët e luftës;


Që Dija, Kultura dhe Arsimi të ndriçojnë dhe jo të verbojnë, të fisnikërojnë dhe jo të perversionojnë fëmijët tanë të pafajshëm e të pamëkatë, o Zot i Madh që krijove Gjithësinë e paanë, më bëj aq të pasur e të mençur, sa të ngre një Universitet për çrrënjosjen e të gjitha universiteteve, ose përndryshe, merre mbrapsht dhuntinë dhe pasionin që më dhe! Amin! ■

# Matura sukses apo

**Pas përfundimit të testit të maturës flasin për sukseset dhe dështimet e saj**



**"Ka pasur mospërputhje të listave që ka sjellë Drejtoria Komunale, por edhe ne si komision po të kishim dashur do të kishim vepruar në mënyrë që ata maturantë të mos i linim të hynin më në provim. Por ne kemi zgjedhur metodën që më mirë të vonohemi e të na dalë pak punë, në mënyrë që t'i mundësonim çdo maturanti të hynte në provim, sesa ata të humbnin një vit" - ka deklaruar Nehat Mustafa, kryetari i Komisionit Qendror Shtetëror për Testin e Maturës (KQSHTM)**



**Qendresa MUSTAFA**

Prishtinë, 11 shtator - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka vlerësuar pozitivisht suksesin dhe organizimin e testit të maturës. Sipas Komisionit Qendror, përveç disa parregullsive të vogla, të cilat sipas tyre kanë ndodhur nga Drejtoria Komunale ose nga individë të caktuar, testi i maturës këtë vit ka shkuar në rregull. Ky komision madje konsideron se është arritur një rezultat mjaft i mirë dhe i pritur.

Por ndryshe mendon eksperti i kësaj fushe, i cili duke komentuar procesin e maturës, parregullsitë dhe ankesat e nxënësve, në përgjithësi konstaton se arsimi në Kosovë ka kohë që është në krizë. Sipas tij, edhe përkundër një përparimi që kanë bërë nxënësit, ata mbeten ende shumë larg objektivave mësimore.

Ndërkaq vetë nxënësit kanë mendime të ndryshme. Disa mendojnë se testi i maturës ka shkuar siç është më së miri, e disa janë totalisht të dëshpëruar me organizimin e këtij procesi.

## Mustafa: Jemi të kënaqur me maturën 2009

Kryetari i Komisionit Qendror Shtetëror të Maturës (KQSHM), Nehat Mustafa, ka thënë se ky komision e ka vlerësuar pozitivisht testin e maturës, edhe përkundër disa parregullsive të vogla që kanë ndodhur gjatë testit të maturës.

"Nëse thuhet se ka pasur shumë parregullsi atëherë duhet të evidentohen se cilat janë ato dhe nëse dikush mendon se në ndonjë shkollë ka pasur parregullsi, pra, diçka që ka ndikuar në proces, atëherë ne kemi argumentin tjetër që, përkundrazi, parregullsia

# a2009,
# o dështim?

**"Testi i maturës mati nivelin e zotërimit të objektivave mësimore. Mossuksesi dëshmoi se nxënësit nuk i kanë përvetësuar njohuritë në masën e duhur. Këto rezultate edhe kanë qenë të pritshme, sepse ka vite që sistemi ynë i arsimit është në krizë" - ka thënë eksperti i arsimit Dukagjin Pupovci, duke shtuar në këtë kontekst se për këtë gjendje më së paku duhet të fajësohen nxënësit"**

është shkaktuar duke u dalë në ndihmë maturantëve" – ka thënë Mustafa duke treguar më pas se shumë maturantë nuk e kanë paraqitur provimin e maturës dhe kanë ardhur pa qenë në lista.

Sipas tij, parregullsi të tjera gjatë testit të maturës nuk ka pasur përveç ndonjë rasti individual, që nuk e ka dëmtuar procesin.

"Gjithçka ka shkuar në rregull dhe nuk ka pasur probleme që mund ta dëmtonin procesin. Mund të ketë pasur raste individuale, por nuk ka pasur forma të organizuara gjatë testit të maturës" – është shprehur Mustafa.

Ai ka thënë se testi i maturës ka qenë i organizuar mirë dhe se ka pasur madje edhe nga ata maturantë që i kanë quajtur rigorozë.

"Në themi se testi i maturës ka qenë i organizuar mirë, madje kemi edhe studentë që na kanë akuzuar se kemi qenë shumë rigorozë në monitorim dhe vlerësim" – ka thënë kryetari i KQSHM-së.

I pyetur se a ka qenë një kalueshmëri e ulët e maturantëve në testin e maturës, Mustafa është përgjigjur se: "Nuk mund të konstatojmë se ka pasur kalueshmëri të ulët, sepse dihet se në afatin e dytë testit i janë nënshtruar ata maturantë që nuk kanë pasur sukses pozitiv në afatin e parë. Po të mblidhen të dy afatet, kalueshmëria e përgjithshme arrin në 70 për qind" – ka deklaruar ai.

Ndër të tjera ai ka treguar se numri më i madh i maturantëve që kanë pasur sukses në testin e maturës kanë ardhur nga gjimnazet, ndërsa kalueshmëria më e ulët ka qenë në shkollat profesionale, aty ku realisht kanë shkuar nxënësit më të dobët. Ai ka shtuar se komisioni do t'i bëjë analizat më të hollësishme mbi testin e maturës, madje duke shikuar çdo detaj të saj.

"Analiza e vërtetë fillon tash. Do të analizohet çdo pyetje e të dy afateve ndaras, do të shikohet se a ka funksionuar një pyetje, a ka qenë më e lehtë, më e rëndë apo ka qenë jashtë kontekstit shkollor" – ka deklaruar Mustafa, duke bërë me dije se krejt në fund do të bëhet edhe krahasimi i rezultateve me ato të viteve të kaluara.

## Pupovci: Arsimi në Kosovë është në krizë

Mirëpo ndryshe mendon eksperti i arsimit Dukagjin Pupovci. Sipas tij ka vite që sistemi i arsimit në Kosovë është në krizë dhe këtë e ka dëshmuar edhe testi i maturës, i cili mat nivelin e zotërimit të objektivave mësimore.

"Nxënësit mund të fajësohen më së paku për këtë mossukses, sepse gjatë shkollimit të mesëm, atyre nuk u është kërkuar të lexojnë librat, programet kanë qenë të stërngarkuara, tekstet joadekuate, orët shpesh janë mbajtur me orar të shkurtër 30 minuta, nuk kanë pasur mjete konkretizimi, ndërsa shumë shkolla e kanë humbur sensin e rendit dhe disiplinës" – ka deklaruar Pupovci.

Sipas tij, edhe pse këtë vit administrimi ka qenë më i mirë krahasuar me vitet e kaluar, ende kanë vazhduar të jenë prezentë mashtrimet e parregullsitë e ndryshme në vendet e testimit.

"Ka pasur raportime të shumta të mashtrimeve që bëhen në vendet e testimit, duke lejuar nxënësit të kopjojnë, bile dhe duke u ndihmuar t'iu përgjigjen pyetjeve. Mendoj se këto raportime duhet të merren me shumë seriozitet, sepse e bëjnë testin jo të besueshëm" – ka theksuar ai.

Pupovci është shprehur se për përmirësimin e kësaj gjendje të krijuar, MASHT-i duhet të punojë shumë me maturantët, por duhet edhe të përgatitë më shumë trajnime për mësimdhënësit.

"Eliminimi i kopjimeve është hapi i parë që duhet bërë. Ndërkohë, duhet të bëhen përpjekje për rishikimin e programeve mësimore, për kompletimin me tekste cilësore, për trajnimin e mësimdhënësve, për përmirësimin e infrastrukturës, etj." – ka pohuar Pupovci, duke shtuar se masat e tilla sjellin rezultate, por jo rezultate të shpejta.

"Megjithatë, fakti se do të duhet kohë për të arritur rezultate nuk duhet ta dekurajojë askënd, sepse, përndryshe, rezultatet nuk do të arrihen asnjëherë" – është shprehur ai.

## Maturantët të kënaqur dhe të dëshpëruar

Edhe maturantët kanë mendime të ndryshme rreth organizimit të testit të tyre. Disa, të cilët kanë pasur një përgatitje më të mirë nga shkollat e mesme, mendojnë se testi nuk ka qenë i vështirë.

"Nuk mund të them se testi ka qenë i vështirë për mua që vij nga gjimnazi 'Sami Frashëri', pasi pyetjet e testit kanë qenë nga lëndët që i kemi mësuar në shkollë" – shprehet V. Rexha.

Në anën tjetër, kishte nxënës që ishin të dëshpëruar nga organizimi i testit. Ata e bënin fajtor Ministrinë e Arsimit, e cila sipas tyre e kishte hartuar testin me pyetje të cilat ata nuk i kishin mësuar fare në shkollë.

"Për neve që jemi nga shkolla e mesme '28 Nëntori', testi ka qenë shumë i vështirë pasi pyetjet në test kanë qenë të formuluara nga lëndët të cilat në shkollën tonë nuk ekzistojnë fare" – ka thënë E. Krasniqi, duke e fajësuar për këtë MASHT-in. ■



Provimi i parë i Maturës Shtetërore 2009 është mbajtur më 6 qershor dhe është realizuar në 29 komuna të Kosovës, në gjithsej 98 qendra testimi. Provimit të Maturës Shtetërore i janë nënshtruar gjithsej 25 mijë e 764 maturantë, prej të cilëve 11 mijë e 656, ose në përqindje 45.66%, e kanë kaluar provimin e maturës.
Pjesa tjetër, prej 13 mijë e 937 maturantëve ose 54.1%, nuk ka arritur të ketë rezultate pozitive.
Ndërsa provimi i dytë i Maturës Shtetërore 2009 është mbajtur më 26 gusht dhe është realizuar në 66 qendra testimi. Provimit i janë nënshtruar 14 mijë e 450 maturantë, prej të cilëve 6 mijë e 210 ose në përqindje 43% e kanë kaluar provimin e maturës, ndërsa pjesa tjetër, prej 8 mijë e 220 maturantëve ose 57 për qind, ka dështuar për të dytën herë në kalimin e këtij provimi.

### Intervistë me atdhetarin e shquar Masar Krasniqi

# Njeriu i cili ka bërë gjithçka pë

**Intervistoi: Muhamet Jahiri**

Është njëri nga atdhetarët më të shquar të kombit shqiptar, që tërë jetën e vet ia kushtoi punës së palodhur për pavarësinë e Kosovës. Ai tregon se si ka arritur të shkojë në skajin jugor të planetit, për të treguar edhe atje për padrejtësitë që po u bëheshin shqiptarëve të Kosovës dhe se si ka arritur ta marrë çmimin më prestigjioz, atë të mbretëreshës së Zelandës së Re. Ai thotë se ka arritur të jetë njëri ndër njëqind myslimanët më të suksesshëm dhe se ka ndërtuar xhaminë e parë në Zelandën e Re.

Krasniqi tregon për vuajtjet e shqiptarëve nën okupimin serb. Ai e kishte vënë shumë herë edhe jetën në rrezik, në përpjekjet e tij për të arritur në perëndim dhe për të treguar vuajtjet e popullit të tij.

Ai ka arritur ta ndërkombëtarizojë Kosovën dhe ka arritur që në shumë konferenca ndërkombëtare t'i tregojë mizoritë e pushtetit serb. Ai ka themeluar parti, organizata e lobe të shumta, të cilat kanë qenë vendimtare në ndërkombëtarizimin e fatit të shqiptarëve.

Ai tregon se si është njoftuar me Xhuzepe Dio Gardin dhe si i kanë koordinuar punët për të lobuar për lirinë e shqiptarëve në Kosovë.

Për më shumë flet, në një intervistë për revistën "Paqja", atdhetari i shquar shqiptar Masar Krasniqi

**PAQJA:** ***Z. Krasniqi a mund të na flisni për jetën tuaj para emigrimit në Zelandën e Re?***

**KRASNIQI:** Jam i lindur në Vushtrri, ku edhe kam mbaruar shkollën fillore. Më pas, në vitin 1941 kam filluar normalen në Prishtinë. Në vitin 1944, para se komunizmi t'i marrë frenat në dorë, unë jam arratisur, pasi që isha ushtari më i ri në mbrojtje të Kosovës, nën komandën e Adem Selimit, ose siç quhej Adem Gllavica. Në vitin 1945 fillova të merrem me muzikë dhe kam kënduar në Radio Kosovë. Nuk shkoj kohë e gjatë dhe për përpjekjet e mia atdhetare rashë në duar të UDB-së. Ata më keqtrajtuan shumë dhe kërkuan nga unë që ose t'u rrëfej atyre gjithçka, ose do të ma hiqnin mishin copë-copë. Kërkonin t'u tregoja për Luan Gashin, Adem Gllavicën, Imer Berishën si dhe të tjerë, dhe kërkuan nga unë që të nënshkruaj një dokument, i cili do t'u hapte rrugën atyre për t'i pushkatuar ata dhe dy fotografë të Mitrovicës.

Por unë nuk pranova dhe iu thashë se ata nuk kanë qenë kurrë ushtarë, prandaj nuk mund ta nënshkruaja atë dokument. Pas lirimit shkova në gjimnazin e Prizrenit dhe më vonë ika në Shqipëri.

### Tri përpjekjet për të ikur në perëndim!

**PAQJA:** ***A mund të na thoni se pse synonit që të largoheshit nga vendlindja?***

**KRASNIQI:** Qëllimi im ishte që të ikja jashtë, në Amerikë ose në perëndim dhe t'i vazhdoja përpjekjet e mia për lirinë e popullit.

Pasi shkova në Shqipëri u punësova në Durrës, pranë doganave detare, aty ku zbarkonin anijet. Aty punova për tre muaj. Vendosa të rrezikoj dhe t'ia mbathi prej aty, prandaj hipa në një anije italiane "Fanny Brunet", ku edhe u fsheha për të pritur nisjen e saj. Qëndrova i fshehtë për tri ditë pa ngrënë e pa pirë. Pas të gjitha përpjekjeve, në natën e katërt më kapën pasi një punëtor i anijes më diktoi se ku isha fshehur. Në atë kohë ishte viti 1946, dhe unë isha vetëm 15 vjeçar. Më nxorën jashtë, duke më quajtur tradhtar të popullit, dhe më dërguan në zyrë ku kërkuan ta dinë se pse kam tentuar të ikë. Aty më rrahën dhe më dërguan në burg. Pas kësaj arrita që përmes Maqedonisë të kthehem përsëri në Kosovë dhe pas shumë përpjekjeve arrita në shtëpi, por gjendja ishte shumë e rëndë. Pas kësaj më kërkonin, por e ndërrova identitetin dhe shkova në Beograd për të vazhduar studimet për muzikë, por gjithnjë duke e pasur mendjen te përgatitja për të ikur jashtë Jugosllavisë për në perëndim.

**PAQJA:** ***Z. Krasniqi, pas shkuarjes suaj në Beograd, sa kohë ju desh që të filloni përpjekjet për të marrë rrugën e ikjes nga Jugosllavia e asaj kohe?***

**KRASNIQI:** Në fund të 1948, në Beograd më kishte zbuluar UDB-ja dhe kishte filluar të më kërkonte në vendin ku jetoja. Duke e parë rrezikun që po më kanosej, fillova përpjekjen time të dytë për të ikur, por kësaj radhe tentova përmes Sllovenisë, por tashmë më jo i vetëm, por me disa shokë të tjerë. Në mëngjesin kur ne tentuam t'ia mësyjmë kufirit për në Austri, përsëri na kapën. Aty na zuri një slloven dhe na dorëzoi në ushtrinë sllovene. Ata e dinin se jemi shqiptarë sepse aty kalonin shumë shqiptarë. Ata e dinin se ne po tentonim të iknim në Austri. Ushtarët slloven na liruan, por na thanë të largohemi shpejt, sepse aty pritej arritja e ushtrisë serbe, e cila mund të na vriste. Kjo ngjarje ndodhi në fund të vitit 1948. Gjatë kthimit na zuri ushtria, por falë ushtrisë sllovene ne shpëtuam përsëri.



# ër Kosovën



**PAQJA:** ***Atëherë, z. Krasniqi, kjo do të thotë që edhe pas dështimit tuaj të dytë, ju nuk u dorëzuat, por vazhduat përpjekjet për të shkuar drejt vendeve perëndimore apo drejt ndonjë vendi demokratik?***

**KRASNIQI:** Nga Sllovenia në shkuam në Rijek, ku edhe u vendosëm. Por prapë përpjekja dhe qëllimi ishte për të ikur. Ne aty ishim në një gjendje të vështirë ekonomike. Unë gjeta një punë dhe fillova të punoj në një zyrë, e cila merrej me dëmet e anijeve. Aty përfundova një lloj kursi, i cili i trajtonte njerëzit për kapiten anijeje dhe pas pak kohe hyra në anije, ku, fillimisht, me një anije druri bartja dërrasa vetëm nëpër zonën e detit të Jugosllavisë.

Pas një praktike nëntë mujore u nisa me anijen "Vis" për në Izmir të Turqisë. Sapo m'u dha mundësia dola në qytet dhe arrita t'ia mbath edhe pse më ruanin katër persona. Pas ikjes në Izmir u takova me një polic prej të cilit kërkova ndihmë. Ai e kuptoi se nuk jam turk dhe më pyeti se nga isha. Sapo i tregova që jam shqiptar, ai filloi të fliste shqip dhe më tha se edhe ai vetë është shqiptar.

Pas disa përpjekjeve për të më transferuar në vendlindje, gjë të cilën e kërkonte me çdo kusht ambasada jugosllave në Turqi, arrita të fitoj azilin politik edhe pse nuk ma lejonte mosha. Por kjo m'u mundësua pasi që kryeministri turk i asaj kohe ishte shqiptar nga Prizreni. Sapo më dhanë azilin, shteti turk më ofroi punë, tokë, bagëti dhe më dha mundësinë të filloja një jetë të re aty, por të gjitha i refuzova, duke ju thënë se kërkoja të largohesha në Amerikë ose në perëndim për të vazhduar përpjekjet për çlirimin e popullit tim.

**PAQJA:** ***Z. Krasniqi, pasi që i refuzuat të gjitha këto si mendoje se do t'i realizoje planet e tua?***

**KRASNIQI:** Në vitin 1951, u nisëm me një anije norvegjeze, së bashku me një grup shqiptarësh, për në Zelandën e Re, pasi prej aty nuk mundja për në Amerikë, dhe pas më shumë se tridhjetë ditësh udhëtimi arritëm në Zelandën e Re.

Sapo arritëm pamë se atje jeta ishte e avancuar. Vërehej se në atë vend kishte liri e demokraci. Aty populli na priti rrugës me ëmbëlsira e ushqime. U vendosëm në një ish-kamp japonez, por kushtet aty ishin si në shtëpi.

Pas tre muajsh në kamp na ofruan mundësinë që të zgjidhnim se çka do të punonim.

Në atë kohë Zelanda ishe vend shumë i pasur. Kishte nga gjashtë makineri për çdo kokë banori. Pas një kohe punuam pak, por menjëherë filluam të avancohemi si të pavarur. Hapëm biznese, restorante, dhe filluam të pavarësohemi.

## Nderimi me çmimin e mbretëreshës

**PAQJA:** ***Z. Krasniqi si filluat përpjekjet për çështjen shqiptare?***

**KRASNIQI:** Vitin e parë vetëm diskutonim, ndërsa në vitin e dytë, pra më 1952, ne u mblodhëm dhe formuam degën e Ballit Kombëtar.

U lidhëm me qendrat në Romë, Amerikë dhe Australi dhe u bashkuam në brumin e përgjithshëm për çlirimin e vendit.

Pas kësaj ne nuk jemi ndalur më. Ballin Kombëtar e mbajtëm për 25 vite. Gjatë gjithë kësaj kohe unë kam qenë kryetari i saj, sepse ata kërkonin që unë ta vazhdojë këtë punë.

Ne s'kishim fuqi të ecnim përpara si parti politike, prandaj themeluam një organizatë, "Shqipëria e Lirë", dhe me këtë kishim më tepër mundësi për të lëvizur.

**PAQJA:** ***Në Zelandën e Re ju jeni nderuar edhe me çmimin e mbretëreshës. A mund të flisni për këtë?***

**KRASNIQI:** Arsyeja pse e kam fituar çmimin e mbretëreshës është për punë të shumta.

E para, për çështje humanitare; e dyta, kam organizuar myslimanët në demonstrata kundër Bashkimit Sovjetik; e treta, kam formuar fondacionin e shoqatave myslimane; dhe e katërta, kam ndihmuar ekonominë e Zelandës së Re. Por, edhe për ndihmën që kam dhënë në politikë.

Jam marrë edhe me çështje të tjera. Kam qenë anëtar i organizatës "Evropa e Lirë", që kishte qendrën në Nju Jork. Përherë kam qenë në krye të këtyre organizatave. Unë jam vlerësuar për kontribute të përgjithshme që kam dhënë për njerëzimin.

## Shumë rezoluta për Kosovën

**PAQJA:** ***Kur filluat të flisni për çështjen e Kosovës në konferenca ndërkombëtare?***

**KRASNIQI:** Punën për çështjen e Kosovës e fillova në një konferencë ndërkombëtare në Malajzi, ku po zhvillohej një debat për të drejtat e njerëzve. Aty për herë të parë fola për Kosovën, mirëpo ata nuk dinin asgjë për vendin tonë. Unë ju tregova se ku gjendet Kosova, fola për hallet dhe për vuajtjet që po përjeton populli i Kosovës, për shkeljen e të drejtave njerëzore aty, etj.

Aty ne bëmë një rezolutë për Kosovën, e cila bëri jehonë në të gjitha vendet e botës përmes shtypit.

Ambasadori i Jugosllavisë protestoi menjëherë. Ai, me propagandën e tij, u mundua të tregonte se Kosova i gëzon të drejtat e saj, se ajo ka autonomi, se lejohet shkollimi shqip dhe për këtë arsye kishte sjellë disa libra shqip dhe, po ashtu, ai përdori edhe lloje të tjera propagande.

**PAQJA:** ***Pas Malajzisë, cili ka qenë destinacioni juaj në përpjekjet për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës?***

**KRASNIQI:** Më pas udhëtova drejt ShBA-ve ku, në Universitetin Kolumbia të Nju Jorkut, mora pjesë në një konferencë e rëndësishme. Aty arrita ta marr fjalën edhe përkundër pengesave që më kishin vënë vendet sllave që të isha vetëm dëgjues. Bëra më shumë se 200 kopje, si lloj afishesh, që ua shpërndava të pranishmëve në atë konferencë. Në ato afishe unë pasqyrova realitetin dhe vuajtjet e popullit shqiptar të Kosovës. Të gjitha afishet u shpërndanë dhe të pranishmit filluan t'i lexonin gradualisht disa prej tyre. Pas shumë përpjekjeve unë arrita ta marr fjalën. Tregova për situatën në Kosovë, për gjendjen atje, ju tregova për demonstratat, largimin e punëtorëve nga puna. Aty mora përkrahje të madhe nga disa shtete.

## Lobim për pavarësinë e Kosovës me Dio Gardin

**PAQJA:** ***Ju jeni i lidhur edhe me Dio Gardin, të cilit i keni ndihmuar në krijimin e lobit shqiptar në Zelandën e Re dhe Australi?***

KRASNIQI: Po, jam takuar me Dio Gardin, me të cilin edhe kam biseduar. Ai ka kërkuar nga unë që të themeloj Lobin 'Lidhja e Qytetarëve Shqiptaro-Amerikanë' në Zelandën e Re dhe në Australi. Dhe e pranova. Unë, gjithashtu, realizova edhe një intervistë në radio të lobit. Më pas, u bëra edhe anëtar i kryesisë së lobit shqiptaro-amerikan.

**PAQJA:** ***A e themelove lobin në Zelandën e Re dhe në Australi?***

**KRASNIQI:** Sapo u ktheva në Zelandën e Re, kërkova që të bashkohemi me këtë rrjet të përgjithshëm, i cili do të fillonte nga Amerika dhe do të shpërndahej në tërë botën. Aty u dakorduam dhe formuam "Lidhjen Qytetare Shqiptare në Zelandë". Ne, me Dio Gardin, shkuam edhe në Australi. Ai na njohu me partitë politike, na njohu gjithashtu me parlamentin. Bashkë me të arritëm që të fusim një rezolutë për Kosovën në parlament. Ai hapi dosjen e Kosovës, ndërsa ne paraqitëm kërkesën tonë për Republikë. Ata na premtuan se do të na ndihmojnë në konferenca të ndryshme ndërkombëtare. Dio Gardi kërkoi që ta mbështesin Kosovën pasi atje është gjendja shumë e rëndë. Ai kërkoj që edhe parlamenti i Australisë të nxjerrë sa më parë një rezolutë për Kosovën.

**PAQJA:** ***Ju, pasi u konsoliduat në Zelandë dhe në Australi, i vazhduat përpjekjet për çështjen e Kosovës. Cilat ishin ato përpjekje?***

**KRASNIQI:** Ne bënim politikë dhe përpjekje që çështja e Kosovës të futej në senatin amerikan, aty ku edhe mund të bëheshin ndryshime të mëdha. Ka ndodhur që, brenda një dite, së bashku me Dio Gardin, kemi takuar 17 delegacione, të cilëve u kemi treguar se ku është Kosova dhe cili është realiteti atje. State Departmenti nuk dëshironte që të prishej Jugosllavia. Por ne bëmë shumë shokë në senat dhe përmes tyre kërkuam që Amerika ta ndryshonte politikën ndaj Kosovës. Pas të gjitha përpjekjeve, erdhi dita kur edhe Jugosllavia u shkatërrua.



## Vlerësimi ndër 100 myslimanët më të suksesshëm

**PAQJA:** ***Z. Krasniqi! Ju përmendët çështjen e organizimit të myslimanëve. Juve gjithashtu ju kanë vlerësuar si një prej 100 njerëzve më të suksesshëm ndër myslimanët. Cili është komenti juaj për këtë?***

**KRASNIQI:** Unë jam një ndër ata. Këtë nuk e kam pritur, por ma dhanë sepse kam qenë kryetar i myslimanëve të Zelandës dhe Federacionit mysliman. Kam ndihmuar dhe jam përpjekur të ndërtoj xhaminë e parë në Zelandën e Re, por edhe kam marr vlerësime që kam qenë pjesëmarrës në konferenca ndërkombëtare në shtetet arabe, ku kam biseduar shpesh edhe me sekretarin e përgjithshëm të Konferencës Islamike. Po ashtu, jam angazhuar edhe për organizimin e myslimanëve kundër Bashkimit Sovjetik.

**PAQJA:** ***Cili ka qenë qëllimi i bashkëpunimit me myslimanët?***

**KRASNIQI:** Nuk e di nga erdhi. Ka qenë surprizë për mua. Qëllimet e mia kanë qenë të kontribuoj për çështjen e Kosovës dhe pjesëmarrja në konferenca ka qenë kryesisht për këtë qëllim. I mësova edhe ata ku është Kosova. Në konferencën e parë më kanë kritikuar se po e kritikoj Jugosllavinë.

**PAQJA:** ***Z. Krasniqi! A mund të na thoni për fund se si e keni pritur shpalljen e pavarësisë së Kosovës?***

**KRASNIQI:** Ne e kemi ditur se Kosova do të jetë e pavarur. Lobi e mori në dorë delegacionin e Kosovës, me në krye Ibrahim Rugovën, të cilët i dhanë dëshmi kongresit amerikan për pavarësi.

Kosova do të jetë gjithmonë shtet i lirë. I bëj thirrje edhe parlamentit që të mblidhet sa më parë e të dalë me një deklaratë se s'ka nënshkrime pa Kosovën. Ne kemi përkrahjen e Amerikës dhe përkrahjen e shteteve të forta si Franca, Italia, Japonia, Anglia. Jam i sigurt se serbët do të humbin edhe në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND). Rroftë Kosova! ■

### Braktisin shkollën për të mbajtur familjet e tyre

# Fëmijët kryefamiljarë

**"Babanë e kam të sëmurë, kurse motrat dhe vëllezërit i kam më të vegjël, prandaj më duhet të punoj për ta mbajtur falmiljen. Me paratë që fitoj blej ushqim për familjen time dhe barna për babanë e sëmurë" - shprehet Durimi.**



**Fatos SHALA**

"Cigare…mbushje…" është refreni i zakonshëm që dëgjojmë nga fëmijët nëpër rrugët e Prishtinës. Këto fjalë i dëgjojmë nga fëmijët, të cilët i kanë braktisur librat dhe i kanë zëvendësuar me cigare dhe mbushje. Ata shesin cigare nëpër rrugë, kurse me paratë e fituara mbajnë familjet e tyre.

Durimi, 13 vjeçar nga Prishtina, është njëri nga shitësit e shumtë të cigareve. Me fytyrë të zbehur dhe duke ju dridhur zëri, ai shprehet se duhet të punojë për shkak se nga familja e tij nuk ka kush të punojë. Ai, po ashtu, rrëfen edhe për jetën e rëndë që jeton në familjen e tij.

"Babanë e kam të sëmurë, kurse motrat dhe vëllezërit i kam më të vegjël, prandaj më duhet të punoj për ta mbajtur falmiljen. Me paratë që fitoj blej ushqim për familjen time dhe barna për babanë e sëmurë" - shprehet Durimi.

Ai thotë se, që një kohë të gjatë, është detyruar që t'a ndërpresë shkollën, pasi i është dashur që t'ia kushtojë tërë ditën cigareve, për të shitur më shumë.

### Shkollat në dijeni, por pa fuqi ndërmarrëse

Në shkollat e kryeqytetit thonë se janë në dijeni që një numër nxënësish punojnë. Por, sipas tyre, ata nuk kanë fuqi që të ndërmarrin diçka. Ata thonë se të gjitha librat dhe fletoret i kanë falas nga Qeveria e Kosovës, por sipas tyre kjo nuk është e mjaftueshme që ata të vijojnë mësimin, sepse atyre ju mungojnë gjërat elementare për jetesë.

Selami Reqica, drejtori i shkollës "Nazmi Gafurri" thotë: "Në shkollë gravitojnë nxënës nga rrethina e Prishtinës dhe nga lagje të largëta. Kushtet ekonomike janë faktori kryesor që ndikojnë edhe në mbarëvjatjen e mësimit dhe, për këtë arsye, një numër i konsiderueshëm i nxënësve detyrohen ta ndërpresin mësimin dhe të shesin gjëra të ndryshme."

Njësoj sikurse Durimi punon edhe Milot. B, një i ri 14 vjeçar. Edhe ai shprehet se nuk ka mundësi të tjera që të sigurojë ushqim për familjen dhe se i duhet të bëjë këtë punë.

"Ka dy vjet që shes cigare dhe mbushje. Më shumë dal ditëve të tregut sepse fitoj më shumë. Jetoj në një shtëpi pa kurrfarë kushte për jetë, në lagjen Emshir" - shprehet i mllefosur Miloti.

Ai thotë se është nxënës në klasën e gjashtë në shkollë fillore, por nuk pranon ta tregojë emrin e shkollës, sepse ai thotë që nënçmohet nga moshatarët e tij.

### Ademi: Kjo është një dukuri shqetësuese për shoqërinë tonë

Sociologu nga Prishtina, Ilir Ademi, shprehet për këtë problem duke thënë se gjendja mentale e kësaj kategorie fëmijësh, që punojnë në treg dhe në vende të tjera, është e vështirë. Dhe sipas tij, kjo është një dukuri e cila duhet të na shqetësojë të gjithëve".

"Këto familje zakonisht kanë shumë anëtarë, ose janë shfrytëzues të ndihmave, ose kanë një pagë mjaft të ulët, kështu që fëmijët dalin të punojnë për të siguruar ekzistencën e familjes", - thotë Ademi.



Tanimë disa fëmijë, që bredhin rrugëve të Prishtinës me cigare dhe mbushje, janë bërë kryefamiljarë. Secili prej tyre do të dëshironte të kishte një jetë më të mirë, ose që edhe kohën e lirë t'ia kushtonte lodrave, ose ndonjë aktiviteti tjetër, por ja që fati i tyre nuk është i ngjashëm me fëmijët e tjerë. Edhe këta ëndërrojnë që një ditë do të kenë fatin e tyre të mirë dhe do të bëhen zot kur të rriten.Por e ardhmja e tyre mund të përcillet edhe me sjellje asociale dhe trauma. ■


Sipas sociologëve, fëmijët të cilët punojnë dhe janë mbajtës të familjes kanë gjasa të mëdha të mos e vijojnë shkollimin dhe të mbesin punëtorë krahu, pa një perspektivë të qartë. Këtyre fëmijëve u mungon shumëçka: atyre iu mungon ngrohtësia familjare, ngase ata pjesën më të madhe të kohës e kalojnë në rrugë. Për këtë kategori fëmijësh dhe për familjet e tyre duhet pasur më shumë kujdes për mënyrën se si duhet të ndihmohen ata.





U shënua 10 shtatori – Dita Botërore e Parandalimit të Vetëvrasjeve në Kosovë

# Vetëvrasjet, sfidë për gjithë njerëzimin!



Astrit VELIQI

Për nder të ditës botërore për parandalimin e vetëvrasjeve, më 10 shtator 2009, në Prishtinë, u organizua një tryezë e rrumbullakët nga Shoqata e Kosovës për Parandalimin e Vetëvrasjeve, në bashkëpunim me ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës.

Me këtë rast, ministri i Punëve të Brendshme në Qeverinë e Kosovës, Zenun Pajaziti, tha se është shqetësues fakti se në Kosovë, statistikat po tregojnë se vetëvrasjet po shënojnë rritje dita-ditës.

"Ne si ministri kemi krijuar një mekanizëm të brendshëm qeveritar me qëllimin e parandalimit të këtij fenomeni shkatërrues për shoqërinë në përgjithësi" - tha ministri Pajaziti.

Sipas tij, përpjekjes në parandalimin e vetëvrasjeve në Kosovë, në masë të konsiderueshme, i ndihmon edhe mbështetja e shoqërisë civile, që me këshilla dhe organizime të ndryshme e bëjnë edhe më të fuqishme dhe më të plotë rrugën e nisur.

**Vetëvrasjet janë bërë, gjithnjë e më shumë, një sfidë e patejkalueshme në nivel global dhe parandalimi i tyre kërkon një qasje ndryshe nga të gjitha institucionet relevante në botë.**

### Institucionet: Qytetarët duhet të solidarizohen

Ministri Pajaziti u shpreh, po ashtu, se që nga paslufta e këndej në Kosovë janë bërë trende pozitive në shumë procese të ndryshme, por fenomeni i vetëvrasjeve në këtë aspekt është bërë edhe më shqetësues. Parandalimi i këtij fenomeni bëhet vetëm duke punuar pozitivisht dhe ky zhvillim duhet të varet nga të gjithë.

Ndërsa zëvendësministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Gjergj Dedaj, theksoi nevojën e domosdoshme të ndihmës së këtyre personave që janë kategori me nevoja të veçanta.

"Shumë shpesh marr letra nga qytetarë të ndryshëm nga gjithë Kosova, të cilët shprehin problemet dhe brengat e tyre në aspektin social dhe, në shumë raste, ata edhe kërcënojnë se po nuk na ndihmove ne do të bëjmë vetëvrasje" - tha Dedaj.

Ai, fenomenin e vetëvrasjeve, e konsideroi sfidë socio-ekonomike në Kosovën e pasluftës, duke potencuar se Ministria e Punës po mundohet të ndihmojë në të gjitha format e mundshme këto kategori njerëzish. Sot në Kosovë marrin asistencë sociale rreth 40 mijë familje.

Po ashtu, Dedaj potencoi se në botë ndodhin rreth 1 milion vetëvrasje brenda vitit dhe po aq tentojnë të vetëvriten, andaj puna jonë për parandalimin e këtij fenomeni duhet të mbetet e përbashkët për të gjithë.

### Vetëvrasjet në Kosovë alarmante

Psikologja Behare Rexhepi, drejtoreshë e Shoqatës së Kosovës për parandalimin e vetëvrasjeve, tha se situata në Kosovë sot është alarmante. Numri i vetëvrasjeve pothuaj çdo ditë e më shumë është duke shkuar në rritje.

"Dita botërore për parandalimin e vetëvrasjeve është një iniciativë ndërkombëtare që organizohet çdo vit në tërë botën, ku në secilin shtet të botës bëhet një fushatë në nivele kombëtare për ta sensibilizuar opinionin mediatik, opinionin e masës popullore si dhe të personaliteteve të ndryshme politike, kulturore dhe shkencore" - tha psikologja Rexhepi.

Sipas saj gjendja e vështirë ekonomike, depresioni, gjendja shëndetësore, si dhe droga, janë nxitëse të vetëvrasjeve dhe çdo program dhe ak-

tivitet për parandalimin e vetëvrasjeve e zvogëlon numrin e individëve që duan të vetëvriten.

Kjo shoqatë, sipas psikologes Rexhepi, ka bërë disa projekt-propozime, që u janë dorëzuar disa ministrive përkatëse për parandalimin e vetëvrasjeve, të cilat kanë të bëjnë me një hulumtim dhe studim në tërë territorin e Kosovës mbi shkaqet, kushtet, gjendjen dhe arsyen e vetëvrasjeve dhe tentim vetëvrasjeve, mbi formimin e një këshillimore për rastet depresive dhe për familjarët që kanë pësuar raste të tilla në shtëpitë e tyre, si dhe për informimin, këshillimin dhe zbulimin e rasteve në të gjitha shkollat e mesme dhe fakultetet e Kosovës.

Ndërsa sociologu Fatmir Qallaku tha se vetëvrasja është problem kompleks si dhe dukuri sociale –patologjike.

"Vetëvrasja është akt individual dhe për parandalimin e saj kërkohet angazhimi i të gjithëve. Supozohet se pamundësia ose paaftësia njerëzore e vënë në udhëkryq jetën e njeriut dhe, si e tillë, vetëvrasja ndodh edhe e imponuar" - tha Qallaku.

Kurse Ismet Hebibi, mjek, tha se shkaqet më të shpeshta të vetëvrasjeve janë: traumat e lindura, frika, pasiguria, papunësia, horizonti i mbyllur etj.

Sipas tij, parandalimi i vetëvrasjeve duhet të bëhet me një angazhim të gjithanshëm institucional e shoqëror.

## Vetëvrasjet dhe tentim vetëvrasjet në Kosovë nga viti 1999 deri në gusht të vitit 2009

Kapiten Çlirim Hajdini, nga Policia e Kosovës, tha se duke u bazuar në statistikat e këtyre viteve numri i vetëvrasjeve në Kosovë ka shënuar rritje.

Gjatë kësaj periudhe në Kosovë janë shënuar gjithsej 588 raste vetëvrasjesh dhe 1280 tentim vetëvrasjesh.

Vetëvrasjet, nëpër vite, janë si vijon: në vitin 1999 janë dy vetëvrasje, në vitin 2000 janë shënuar 52 vetëvrasje, 2001 janë 74 vetëvrasje, 2002 janë 52 vetëvrasje, 2003 janë 63 vetëvrasje, 2004 janë 67 vetëvrasje, 2005 janë 55 vetëvrasje, 2006 janë 64 vetëvrasje, 2007 janë 56 vetëvrasje, 2008 janë 57 vetëvrasje, si dhe nga janari i vitit 2009 deri me 31 gusht të këtij vitit janë shënuar 49 vetëvrasje dhe disa tentime vetëvrasjeje.

Kurse në bazë të rajoneve, në territorin e Kosovës, për vetëvrasje e para është Prishtina me 148 raste, mandej Peja me



117 dhe numri më i vogël i vetëvrasjeve është shënuar në Ferizaj. Gjinia mashkullore prin ndaj asaj femërore në numrin e vetëvrasjeve.

## Vetëvrasjet në botë

Bazuar në Organizatën Botërore të Shëndetësisë, çdo vit më shumë se 1 milion njerëz në tërë botën vetëvriten. Totali i njerëzve që vdesin çdo vit është edhe shumë më i madh se sa numri i vetë viktimave nga atentatet terroriste, të luftërave e të kombinimit të rasteve të ndryshme.

Pra, çdo minutë, dy persona vetëvriten në botë dhe disa miliona njerëz bëjnë tentim vetëvrasjeje, të shtyrë nga gjendjet e stresit, nga vuajtjet e ndryshme, nga problemet psikike etj.

Që nga 10 shtatori 2004, Dita Botërore për Parandalimin e Vetëvrasjeve ka përkrahjen e qeverive. Personalitete të rëndësishme politike i përkrahin iniciativat dhe ofrojnë publikisht përkrahjen e tyre në konferenca dhe kongrese të ndryshme, me qëllim që të zvogëlohen dhe parandalohen vetëvrasjet.

Sido që të jetë, forma më e mirë për të parandaluar aktin më kriminal që njeriu i bën vetvetes është rruga e drejtë e tij dhe lidhja e tij me krijuesin e tij, Zotin. ■

## FOTOLAJM



DRENAS, 11 SHTATOR

**Në këtë fotografi shihet një re e madhe tymi që ndot qiellin, ajrin dhe mbush me pluhur pullazet e shtëpive të qytetarëve të Drenasit, të cilët përballen me këtë problem çdo ditë dhe i cili po bëhet ditaditës i padurueshëm. Ky tym, i shoqëruar me flakë, del në një nga oxhaqet e fabrikës së Ferro-Nikelit, e cila nuk përdor kurrfarë filtri ose reduktuesi për tymin e pluhurin.**

**Gjithashtu, ekziston rreziku i ndonjë shpërthimi, që do të kishte pasoja për jetën dhe pasurinë e qytetarëve të njërës prej qendrave më të mëdha të rajonit të Drenicës, Drenasit.**

# Ahmed Zevail – fitues i Çmi

Për më se njëqind vjet, çmimi Nobel është dhënë për të arriturat më të larta në shkencat fizike, paqe dhe letërsi. Gjatë kësaj periudhe, vetëm dy shkencëtarë nga bota islame janë kualifikuar për këtë çmimin në shkencat fizike: Abdus Selami nga Pakistani në fizikë (1979) dhe Ahmed Zevaili nga Egjipti në kimi (1999). Abdus Selami ndërroi jetë më 1996, duke lenë Ahmed Zevailin laureatin e vetëm të gjallë në botën myslimane të çmimit Nobel në shkencat fizike.

Shkenca në botën islame lulëzoi mes shekullit të tetë dhe atij të njëmbëdhjetë. Sikur të kishte ekzistuar çmimi Nobel në atë kohë, në shumicën e rasteve do t'i kishte takuar një shkencëtari mysliman, por sot gjendja është shumë më ndryshe. Përse në botën myslimane zbulimet shkencore pësuan rënie? Çfarë duhet të bëjnë myslimanët që ta rikthejnë përsosmërinë në shkencë që e kishin dikur? Cilat janë perspektivat e tanishme në botën islame? Për të kërkuar përgjigje në këto pyetje, ne iu drejtuam Ahmed Zevailit, i cili shpalos udhëtimin e tij magjepsës drejt çmimit Nobel bashkë me opinionet e tij rreth shkencës në botën islame.

### Rreth profesor Ahmed Zevailit

Profesor Zevaili u diplomua në Universitetin e Aleksandrisë, Egjipt, kurse doktoratën e përfundoi në Universitetin e Pensilvanisë. Nderimet e tij përfshijnë më se njëqind çmime, mirënjohje, urdhra nderi dhe mirënjohje shtetërore nga e tërë bota. Më 1999, Profesor Zuvailit iu nda çmimi Nobel në kimi për zhvillimet e tij nismëtare në fushën e femtoshkencës, duke bërë të mundur observimin e lëvizjes së atomeve individuale në një femtosekond, e cila është, një e milionta e një miliardës së një sekonde.

Profesor Zevaili është gjithashtu i njohur edhe për ligjëratat e tij publike, shkrimet mbi shkencën dhe teknologjinë, edukimin dhe problemet botërore, si dhe për përpjekjet e palodhshme për ta ndihmuar shtresën e paprivilegjuar. Në biografinë e tij të fundit, Lundrimi në kohë – nga profesioni deri në çmimin Nobel, ai rrëfen jetën dhe punën e tij deri në marrjen e çmimit Nobel, ku ndër të tjera ai sugjeron edhe një varg aksionesh konkrete për botën e të paprivilegjuarve dhe ofron një vizion të ri të rendit botëror.

*~ Në një nga komentet tuaja të fundit në gazetën 'Independet', ju citoni një ajet të bukur të Kur'anit se Zoti nuk e ndryshon gjendjen e një populli (nuk ua largon të mirat) përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre. (Kuran 13:11) Përse e cituat këtë verset?*

*Nëse shikoni në kohën kur myslimanët ishin në kulmin e të arriturave, ata individualisht po vepronin si mysliman të mirë, që do të thotë se vazhdimisht lexonin Kur'anin dhe mendonin për gjërat e mira që duhet të bënin, siç ishte, kërkimi i diturisë. Siç e dini, fjala e parë që u shpall nga Kurani ishte fjala 'lexo' dhe ky respekt për diturinë është përsëritur gjithkund në Kur'an, sa që shkencëtarët e mëdhenj gati janë renditur në rangun e pejgamberëve. Prandaj, myslimanët e atyre ditëve e kuptuan rëndësinë e nxënies së dijes. Sot, për shkak të rënies që ka ndodhur në mesin e myslimanëve, ne jemi kapur aq shumë nga ideja e teorisë së konspiracionit, saqë dëshirojmë t'i fajësojmë të tjerët për rënien tonë.

Nuk ka dyshim se, në mendjen time, ekzistojnë shumë forca të jashtme që kanë kontribuar në rënien tonë, por e vërteta është se na mbetet ne për t'u përmirësuar. Ndihem krenar kur shoh ndonjë mysliman, të ri ose në moshë, duke arritur në shkallë të larta. Në çdo rast që shoh, kuptoj se këta njerëz nuk lejuan që gjërat e jashtme t'i pengojnë ata, prandaj edhe kanë vazhduar drejt suksesit. Për këtë, duke u mbështetur edhe në Kur'an, unë konsideroj rënien tonë si problem tonin.

*~Në librin tuaj ju thoni: 'Xhamia Sidi Ibrahim el-Dasuki ishte shumë me rëndësi në jetën time ngase ajo përcaktoi fëmijërinë time të hershme. Shkoja në xhami për të studiuar...Në Islam, xhamia nuk është vetëm për lutje, por është edhe për dituri' (f. 15). A mendoni se kjo vazhdon të mbetet e vërtetë?*

*Fatkeqësisht, në vitet e fundit xhamia është përdorur nga njerëz, të cilët nuk janë aq të shkolluar rreth Islamit, për të propaganduar vështrimet e tyre, e jo pikëpamjet e Islamit, kështu që ka lindur një komponent politik. Është një mungesë shkollimi nga ana e këtyre njerëzve. Duke u rritur në Egjipt, më kujtohet El-Ez'heri si një nga qendrat e ndriçimit të botës. Unë mbase nuk shkova deri në El-Ez'her, ama edhe në qytetin tim kishte një xhami ku shkonim dhe takoheshim me imamin dhe gjëja kryesore që ai do të na thoshte ne si djem të rinj ishte: 'ju duhet të arrini dituri; ti duhet të bëhesh mjeku më i mirë ose inxhinieri më i mirë'. Ne mësonim në xhami. Ishte e mrekullueshme. Dua të them, si të ri që ishim do të takoheshim në xhami ku do të faleshim dhe pastaj të gjithë do të uleshim dhe do të lexonim librat dhe shënimet tona të shkollës. Kështu që xhamia ishte një qendër graviteti për gjithë qytetin.

*~Në shumë vende në libër flisni për rëndësinë e të pasurit 'një pasion' për të arritur diçka. A e kemi humbur ne, si myslimanë, pasionin tonë për shkencë dhe dituri? Nëse po, si mund t'ia rikthejmë këtë gjeneratave të reja?*



# mit Nobel

*Nuk mendoj se e kemi humbur pasionin, jo. Që nga marrja e çmimi Nobel, kam folur gjithandej botës myslimane nga Kajro deri në Malajzi, nga Stambolli deri në Liban dhe mijëra njerëz kanë ardhur në ligjëratat e mia. Ajo çfarë kam zbuluar është se të rinjtë janë të uritur për të arritur, ata e kanë pasionin për arritje. Problemi është se, fatkeqësisht, ata nuk gjenden në sistemin e duhur që do t'i bënte ata të kuptojnë potencialin e tyre. Prandaj, unë shpesh e them se pasuria më e madhe hëpërhë e botës myslimane është kapitali i saj njerëzor. Sikur kjo të shfrytëzohej në mënyrën e duhur dhe sikur ne t'i rindërtonim qendrat e vjetra të përsosmërisë për të tërhequr mendjet më të ndritura, unë besoj se bota myslimane do të pësonte një ndryshim të madh. Ekzistojnë shumë probleme politike, por unë nuk mendoj se problemi me botën myslimane është mungesa e resurseve ekonomike apo mungesa e kapitalit njerëzor. Ne i posedojmë te dyja llojet e resurseve.

*~Disa njerëz mendojnë se feja dhe shkenca nuk mund të ko-ekzistojnë. Cili është qëndrimi juaj në këtë çështje?*

*Disa nga mendjet më të ndritura në botë janë njerëz fetarë. Kështu që pohimi se për të qenë një shkencëtar racional, sipas definicionit, ju nuk duhet të besoni në një fe, është paksa naiv. Gjithashtu mua më duket se është edhe shumë dogmatik. Feja është shumë me rëndësi për njerëzit për një mori arsyesh dhe unë nuk shoh ndonjë konflikt mes dyjave.

*~A e shihni suksesin e disave, si ai i juaji dhe Abdus Salamit, si raste të jashtëzakonshme individuale, apo si shenja të para të një ringjalljeje në botën islame?*

*Jo, nuk i shoh si shenja të reja të ringjalljes, ngase unë gjithnjë e them se kam qenë me fat për të fituar dy gjëra nga fëmijëria ime e hershme dhe rinia ime. Së pari, ndihem krenar për sistemin e vlerave që më është dhënë nga familja dhe mënyra se si jam rritur si mysliman në Egjipt. Nuk u rrita në një sistem ku do të hasja drogën e dhunën; unë kurrë nuk kisha parë një armë para se të largohesha nga Egjipti. Vlerat që mora nga familja ishin tejet me rëndësi për mua dhe më dhanë siguri për atë që kam arritur në jetë. Përveç kësaj, dhe shumë me rëndësi, unë u pajisa me një shkollim të mirë në Egjipt deri në shkallën universitare. Ajo që Amerika më ka ofruar mua është një sistem i vlerësimit dhe mundësisë, dhe kjo është ajo që po na mungon ne në botën islame. Sikur të kisha mbetur në Egjipt, nuk do të kisha qenë në gjendje të bëjë atë që kam bërë për shkak të kësaj mungese të mundësisë dhe vlerësimit për të arriturat.



Më lejoni t'iu jap edhe një shembull tjetër: një pjesë e botës myslimane është shumë e varfër, por ekziston edhe një pjesë e madhe e cila është shumë e pasur. Kjo pjesë shumë e pasur nuk ka investuar në kapitalin njerëzor. Në një udhëtim timin të fundit në Malajzi, u takova me Dr. Mahatir Muhamed, ish-kryeministrin e vendit. Sot, Malajzia është një shtet ku 60% e popullatës së saj janë myslimanë. Është e mundur të shihen rezultatet e eksperimentit që është bërë në Malajzi. Malajzi ka bërë një tranzicion, GDP-ja e së cilës është shumë më e lartë se ajo e shumë shteteve myslimane, dhe gradualisht ata po hynë në botën e zhvilluar, dhe e gjithë kjo është bërë në një vend me 60% të popullatës myslimanë. Ajo çfarë bënë ata ishte investimi në edukim. Dr. Mahatir më tha se, për të bërë një tranzicion prej një vendi gati të pazhvilluar i varur nga kallaji dhe goma në një vend që prodhon mikro-elektronikë dhe të ngjashme, është dashur të investonim deri në 20% të GDP-së në edukim. Andaj mendoj se formula është shumë, shumë e qartë se çfarë mund të nxjerrësh prej kësaj.

*~Në një nga artikujt tuaj të fundit në një gazetë, ju thoni se një nga qëllimet primare të edukimit në botën myslimane duhet të jetë 'promovimi i të menduarit kritik.' Çka mendoni me të menduarit kritik?*

*Të rinjtë janë shumë konfuz hëpërhë; ata nuk e dinë ç'është gabim dhe ç'është e drejtë. Ajo që unë mendoj me të menduarit kritik është se të gjithë ne na është dhënë dhurata e mendjes për të menduar, andaj ne duhet t'i edukojmë njerëzit se ç'është moralisht e drejtë dhe ç'është moralisht gabim dhe në të njëjtën kohë të mendojnë edhe për shkencë. Nuk ka asgjë të keqe nëse studiojmë pikëpamje të ndryshme rreth asaj se çfarë po ndodh në univers. Nëse je një mysliman i mirë, atëherë varet nga ti – ti ke kopshtin me dituri dhe ti vendos çfarë

të mendosh. Por t'i frikësosh njerëzit dhe t'u thuash gjëra si 'Nuk bën ta bësh këtë, mos bën atë, mos lexo rreth kësaj...' kjo nuk është të menduarit kritik. Kjo nuk është ajo që na duhet.

Unë kujtoj se Pejgamberi a.s. nuk do të kishte lejuar një qëndrim ndalues sot, ngase ai ishte progresiv në të menduarit e tij; mesazhi i tij është mesazh paqeje dhe mesazh i të menduarit kritik. Sot në shekullin e njëzetenjë, njerëzit po mendojnë të krijojnë koloni në hënë, njerëzit po mendojnë rreth zbërthimit të gjeneve dhe hapjes së një bote krejt të re për tretmanin e sëmundjeve molekulare, njerëzit po mendojnë rreth observimit të atomeve në një femto-sekonde. Dhe ne si myslimanë duhet të mbahemi me këtë.

*~Në libër thoni, 'Nuk duhet ta ndajmë botën në 'ne' dhe 'ata' dhe nuk duhet të lejojmë krijimin e barrierave përmes sloganeve si 'përplasje civilizimesh', apo 'konflikti mes feve'. Ne na duhet dialog e jo konflikt e përplasje!' Cila mendoni se është mënyra më e mirë për arritjen e këtij dialogu?*

*Më lejoni të them, dhe madje po e shprehi këtë shumë fuqishëm, unë mendoj se ka injorancë në të dy anët. Ekziston një pjesë e madhe e popullatës e cila kam përshtypjen se nuk është e informuar; ata nuk janë mjaft të sofistikuar për të folur në mendjen e perëndimit. Në anën tjetër, perëndimorët për një kohë të gjatë kanë neglizhuar nevojën për të mësuar rreth botës myslimane, duke e krijuar bindjen se patjetër duhet të ekzistojë një konflikt me myslimanët. Me këso qëndrimesh në te dy palët, kurrë nuk mund të arrijmë te dialogu.

Më kujtohet se kur kam ardhur për herë të parë në Shtetet e Bashkuara, ata i quanin japonezët 'japs', ndërsa kinezët 'kinezët e kuq', e kështu me radhë. Sot, për shkak të dialogut dhe për shkak se tashmë kemi filluar t'i kuptojmë kulturat e ndryshme, ekzistojnë restorante japoneze dhe kineze gjithandej shtetit. Kina gjithashtu ka McDonalds...Por e njëjta gjë nuk ka ndodhur akoma me botën myslimane. Për shembull, çfarë dinë ata në SHBA rreth kulturës turke? Do të ishte një fillim i mbarë sikur të mësonin rreth historisë së Perandorisë Osmane e pastaj të mësonin edhe për bakllavanë dhe mikpritjen turke. E njëjta gjë do të ndodhte edhe me arabët. Ne nuk kemi bërë mjaft, kurse në anën e tyre më duhet ta them se edhe ata për një kohë të gjatë e kanë neglizhuar mundësinë e të mësuarit diçka rreth botës myslimane, fesë së tyre ose ndjenjave të forta të myslimanëve rreth fesë së tyre.

Në nivelin individual, të dy palët kanë nevojë të ekspozohen te njëra tjetra më tepër dhe këtu vijnë në shprehje programet shkëmbyese dhe të gjitha llojet e tjera edukative. Por unë më tepër fajin ia lë botës myslimane, ngase ne nuk kemi marrë ndonjë iniciativë për të paraqitur veten tonë ashtu siç ka bërë pjesa tjetër e botës.

*~Ju jetoni në Kaliforni me bashkëshorten dhe dy fëmijët. Si e mbani balancën mes punës, familjes dhe çështjeve të tjera personale?*

*Unë kam qenë me fat në këtë aspekt ngase babai i gruas sime është profesor dhe ajo e ka parë se ç'do të thotë për dikë të punojë me përkushtim. Ajo shpesh ka thënë për mua se dashuria ime e parë është puna ime. Megjithatë, mendoj se fëmijët e mi do të thoshin se jam një baba i përkushtuar. Përpiqem t'i balancoj gjërat. Për shembull, gjithnjë i kaloj të dielat me fëmijët; edhe kur jam në shtëpi duke lexuar ata janë përreth meje. I shoh ata, luaj me ta. Nëse nuk e bën këtë, nëse shkon në ekstrem dhe pohon se puna juaj është gjithçka, atëherë e ke lënë anash një pjesë të madhe të jetës suaj dhe unë nuk besoj se do të kesh fuqi të bësh shumë gjëra të tjera në jetë.

*~Çfarë është ajo që ju mban kaq të motivuar edhe pas marrjes së çmimit Nobel? Po prejardhja juaj si mysliman luan ndonjë rol në këtë?*

*Mendoj se është një përzierje e të gjithave. Para se gjithash, Zoti më krijoi një pasion për gjithçka që bëj. Nëse lexoj një libër, kam pasion për ta përfunduar atë. Gjëja tjetër është prejardhja ime, siç e thatë edhe ju. Kur erdha në Shtetet e Bashkuara, u sfidova. Ashtu siç e kam përmendur në librin tim, u ballafaqova me barriera politike, barriera kulturore dhe barriera shkencore. Kështu që u sfidova për të treguar se dikush me prejardhje si unë, dikush që është mysliman dhe u rrit me xhami dhe gjëra të tilla, mund të arrij diçka.

Sot, përpiqem të shkoj përtej çmimit Nobel dhe të pyes veten a mund t'i ndihmoj njerëzit dhe a mund ta ndihmoj shkencën në përgjithësi. Kujtoj se kjo është edhe për shkak të edukimit tim dhe xhamisë. Prandaj, mendoj se është besimi në jetë, në univers, në vetvete dhe në Zotin, natyrisht, e gjithë kjo që më bën të jem ai që jam.

**Përktheu: Jeton Mehmeti**
Marrë nga: Revista Fountain, 2009



# Aktivitete të shumta të Organizatës INTA gjatë muajit Ramazan



Arber ZEKA

Qendra për Aftësim Profesional "Investimi në të Ardhmen "- INTA me seli në Skënderaj gjatë muajit të bekuar të Ramazanit organizoi me dhjetëra aktivitete në komunën e Skënderajt.








Gjatë këtij muaji organizata INTA me seli në Skënderaj në bashkëpunim me Këshillin e Bashkësisë Islame në Skënderaj ka organizuar tribunën me temën: "Islami në jetën e përditshme" me ligjërues: prof. Nexhmedin ef. Maksuti – kryetar i KBI-së, prof. Ekrem ef. Avdiu – hoxhë nga Mitrovica dhe mr. Driton ef. Morina.

Ligjëruesit gjatë kësaj tribune shtjelluan në detaje tematikën e caktuar për këtë tribunë. Ajo që vlen të cekët është së Shtëpia e Kulturës "Hasan Prishtina" në Skënderaj ishte e vogël për t'i zënë të gjithë të interesuarit për të qenë pjesëmarrës në këtë ngjarje. Që mesazhi i kësaj tribune të arrijë te sa me shumë qytetarë, organizatori ishte përkujdesur që këtë tribunë ta transmetojë edhe në dy televizione lokale në Tv-Mitrovica dhe në Tv-Net në Skënderaj. Pas tribunës qendra INTA shtroi iftar për 50 aktivistë.

## Literaturë falas gjatë këtij muaji







Inta gjatë këtij muaji ka organizuar edhe shpërndarjen e qindra librave dhe fletushkave që kryesisht kanë qenë me përmbajtje fetare dhe edukative. Në mesin e titujve të shpërndarë janë edhe dy libra të botuara nga INTA: "Kurani në jetën e përditshme" të autores italiane Haxhah Liza Abdullah (Angela Milo) të përkthyer nga Mr. Fehim Dragusha si dhe libri "Edukimi i Mirëfilltë" me autor Mr. Driton Morina.

## Iftaret gjatë Ramazanit



Pjesë e aktiviteteve të INTA-s gjatë Ramazanit kanë qenë edhe organizimi i katër iftareve, të cilat kanë qenë të shoqëruara me ligjërata nga hoxhallarë eminentë të vendit. Iftari i parë ka qenë i organizuar për 50 aktivistë të organizatës, iftari i dytë ka qenë i organizuar për 140 studentë dhe besimtarë muslimanë si dhe për 60 vajza studente dhe aktiviste të INTA-s. Pas iftarit ka pasur edhe një program kulturor për 200 pjesëmarrësit e këtij iftarit, ku ligjërues ishte hoxha Enis Rama i shoqëruar edhe nga këndimi i disa ilahive.

Iftari i tretë është karakterizuar me organizmin e iftarit për 150 pjesëmarrësit e ftuar nga gjithë komunat e Kosovës. Iftari përmbyllës u organizuar për strukturat komunale dhe intelektuale të komunës së Skënderajt.

Për ta përmbyllur punën e palodhshme dhe të suksesshme të aktivistëve të vet, INTA ka përgatitur edhe një program festiv në ditën e dytë të Fitër Bajramit, i cili organizohet në lokalet e qendrës INTA.

### Mbahet Tribuna shkencore-fetare: "Të studiuarit agjërueshëm"

# Ramazani pastrim i përgjithshëm për besimtarët

M. ZEJNULLAHU

Të Hënën më 14.09. 2009 në Hotelin Grand në Prishtinë Fondacioni "Nektari i Mirësisë" në bashkëpunim me OJQ "Yvesa" organizuan tribunë shkencore fetare, me temën "Të studiuarit agjërueshëm".




Tribunën e hapi Lavdim Gashi nga fondacioni "Nektari i Mirësisë", i cili foli për aktivitetet e fondacionit në muajt e fundit e në veçanti gjatë muajit të Ramazanit, ku me një buxhet modest dhe një sasi simbolike gjërash ushqimore, ky fondacion u doli në ndihmë shumë familjeve në nevojë. Ndërsa, në emër të OJQ-së "Yvesa" foli Iliriana Alloqi, e cila u fokusua rreth aktiviteteve të kësaj organizate joqeveritare. Tribunës në fjalë iu shtua madhështia kur të pranishmit i freskoi Sallah ef. Feta duke lexuar pjesë nga Kurani Famëlartë.

Më pas fjalën e mori Dr. Dashurie Kryeziu, e cila në aspektin shkencor foli për rëndësinë dhe dobitë e agjërimit. Dr. Kryeziu tha se më të vertetë organizmi ka nevojë për "pushim" dhe agjerimi është më se i nevojshëm. Ajo në mes tjerash tha "Jo veçse me shkencë, por edhe përvoja vërteton se të mbushurit e tepërt të stomakut me pije dhe gjellëra të llojllojshme sjell deri te plogështia dhe lodhja e të gjitha organeve, sepse organi më me rëndësi në organizëm, stomaku, nuk është në gjendje t'i tretë. Stomaku i mbushur bëhet burim i shumë helmeve të rrezikshme për jetën tonë. E logjikshme është se mbushja e pandërprerë e stomakut është një lloj atentati ndaj tij, e me të edhe i organeve tjera të organizmit"

Më pas fjalën e mori Dr. Shefqet Krasniqi, i cili theksoi se përcaktimi i tretë themelor praktik fetar, është urdhri për agjërimin e muajit Ramazan. Ai theksoi se, agjërimi është një ndër pesë kushtet islame, kusht ose themel i ndërtesës së dukshme islame, "Muaji i bekuar i Ramazanit është një thesar i çmueshëm që e pasuron jetën e besimtarit me margaritarë të llojllojshëm dhe përfshinë një gamë të gjërë dimenzionesh në të cilat është evident reflektimi i vlerave të këtij muaji të bekuar. Besimtarët në këtë muaj, agjërojnë edhe me veshë, duke mos dëgjuar haram; agjërojnë me gjuhë, duke mos folur gjëra të ndaluara, etj, e me këtë e pastrojnë shpirtin dhe ngriten më lartë. Po ashtu, agjërojnë me zemër dhe me mendje duke mos përpunuar në mend e as duke mos vulosur në zemër asnjë mendim të keq për vëllezërit e tij". Për tribunën pati interesim të madh, pra kishte një numër të madh pjesëmarrësish, shumica nxënës e studentë. Disa të pranishëm më pas parashtruan një sërë pyetjesh".




### OJQ "Yvesa" organizoi kuiz të diturisë

# Ndahen 200 euro për vendin e parë

Organizata jo Qeveritare "Yvesa" me datë 15.09.09 në Prishtinë ka organizuar një kuiz "Kuizi i diturisë Yvesa 2009". Ky aktivitet që u organizua gjatë muajit të Ramazanit ishte vazhdimësi e aktiviteteve të kësaj organizate e cila tash e gati dy vite funksionon në Prishtinë dhe kryesisht merret me organizime që kanë të bëjnë me gjininë femrërore, mirëpo këtë herë ky aktivitet ishte i hapur edhe për meshkuj. Në kuiz morën pjesë 10 kandidatë, të cilët ishin të përzgjedhur.

Të gjithë kandidatët paraprakisht janë pajisur më pyetjet dhe përgjigjet të cilat i kanë përgatitur organizatoret e që ishin mbi 800 pyetje. Në fund të kuizit të gjithë pjesëmarrësve iu ndanë libra, që ishin dhuratë nga organizata, kurse për tri vendet e para përveç tjerash u sigurua edhe një shumë e të hollave. Është me vlerë të ceket se, edhepse shumica e kandidatëve pjesëmarrës në kuiz ishin meshkuj, gjithsej 6 nga 10 sa ishin gjithsej, tri vendet e para i fituan femrat. Vendin e parë e zuri Besa Ramadani e cila edhe fitoi 200 euro, vendin e dytë Afërdita Asani të cilës iu ndanë 100 dhe vendin e tretë e zuri Kaltrina Zatriqi të cilës iu ndanë 50 euro. Pjesëmarrësit u ndanë të kënaqur me këtë lloj organizimi.

Organizatorët premtuan që ky lloj projekti do të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe do të zgjerohet edhe më tepër.



# “VESA”- mjaft aktive gjatë Ramazanit

**Muaji i Ramazanit ishte karakteristik edhe në aspektin e realizimit të projekteve të ndryshme.Në këtë drejtim, "Vizioni për edukim, studim dhe Avnacim" – VESA, ishte mjaft aktive duke participuar me implementimin e projekteve të natyrave të ndryshme përgjatë gjithë këtij muaji**





**Driton KURTI**

Organizata joqeveritare "Vizioni për edukim, studim dhe Avnacim" – VESA, e cila vepron dhe shtrin aktivitetin e saj në qytetin e Mitrovicës gjatë gjithë muajit të madhërishëm të Ramazanit ishte mjaft aktive sa i përket organizmit të aktiviteteve të ndryshme shoqërore-kulturore e po ashtu edhe atyre bamirëse.

Në këtë kontekst përgjatë gjithë muajit, qyteti i Mitrovicës u karakterizua nga realizimi i projekteve të natyrave të ndryshme, duke filluar nga iftaret e përbashkëta, takimet me studentë e deri tek aktivitetet bëmirëse dhe programet të karakterit shoqëror.

“VESA”, filloi këtë cikël të realizimit të aktiviteteve të lartëcekura, javën e parë të muajit të Ramazanit duke startuar kështu me implementimin e një projekti modest mirëpo shumë të rëndësishëm që përfshinte shprendarjen e pakove të mbushura më gjësende ushqimore dhe higjienike për më tepër së 70 familje të qytetit tonë. Karakteristikë domethënëse e realizimit të një projekti të tillë ishte vizita te familjet e minatorëve në fshatin Stantërg, te të cilat u shpërndanë rreth 30 pako.

Ky projekt përfshinte dy faza të realizimit të tij, faza e parë e së cilit është realizuar në gjysmën e parë të muajit të Ramazanit, ndërsa faza e dytë ne gjysmën e dytë të muajit në fjalë.

Një iniciativë e tillë u mirëprit shumë mirë nga qytetarët dhe zgjoi interesim të madh te një pjesë shumë e madhe e tyre, të cilët treguan gatishmërinë e tyre për kontribut të vazhdueshmë në mënyrë që një projekt i tillë të realizohet në vazhdimësi.

Projektet e radhës ishin organizimi i takimeve respektivisht ifatreve të përbashkëta me të rinjtë e qytetit ndërsa në këtë drejtim vlen të veçohet takimi i organizuar me studentë e qytetit të cilët vijojnë studimet në Universitetin e Prishtinës.Në një organizim të tillë merrnin pjesë studentë të të gjitha profileve të UP-së. Mysafir special në këtë takim ishte, hoxha i nderuar, Enis Rama. Gjithashtu vlen të theksohet se shpërndarja e broshurave respektivisht posterave me porosi të caktuara për jetën e secilit njeri dhe të rëndësishme për përkujtimin sa i përket muajit të Ramazanit dhe mirësive të tij ishin pjesë përcjellëse e përmbushjes së planit përkatës.

Pjesa përfundimtare e realizimit të agjendës së paraparë për implemetimin e projekteve gjatë këtij muaji parasheh realizimin e iftareve të radhës me mysafirë nga mbarë vendi ynë si dhe përmbylljen festive të përmbushjes me sukses të planit të paraparë që koincidon edhe me festën e Fitër Bajramit e që është organizimi i programit shoqërorkulturor, me pjesëmarrje të mysafirëve të ndryshëm dhe të veçantë, ndër të cilët hoxhallarët tanë të njohur dhe hafëzët e rinj të qytetit.

Shikuar në tërësi realizimi dhe përmbyllja në mënyrë të suksesshme e këtij plani të paraprë, tregon edhe njëherë për punën e palodhshme dhe kontinuale që janë duke e bërë anëtarët e "Vizioni për Edukim, Studim dhe Avancim"-VESA, në drejtim të avancimit të jetës rinore në qytetin e Mitrovicës dhe kultivimit të vlerave të mirëfillta te të rinjtë tanë. ■










### Memoar nga një aktivitet i Organizatës "Paqja Studentore"

# Mysafirë që ma shtuat imanin



Në kuadër të organizatës bamirëse-humanitare "Kalliri i Mirësisë", në Prevallë të Prizrenit funksionon restoranti "Kulla e jetimit". Kjo organizatë përkujdeset për 350 jetimë të të dy gjinive, që përfshijnë fëmijë të moshës deri në 14 vjet. Këta jetimë (pa marrë parasysh se janë pa një, ose pa të dy prindërit) ndihmohen me gjëra ushqimore, me shkollim dhe me një pagesë simbolike mujore prej 30 eurosh. Fëmijët jetimë janë strehuar në familjet e tyre, por në fillim të çdo muaji bëhet shpërndarja e të mirave materiale, si edhe e gjërave të tjera të nevojshme. Këtë të drejtë (30 euro në muaj) e shfrytëzojnë 70 jetimë, të cilët janë kryesisht nga rrethi i Prizrenit. Përveç këtyre fëmijëve, kjo organizatë përkujdeset edhe studentë të degëve të ndryshme të Universitetit të Prishtinës.



**Mevlude ZEJNULLAHU**

Emërkura e 26 gushtit mblodhi para Fakultetit të Filologjisë shumë studentë të të gjitha drejtimeve të Universitetit të Prishtinës. Nuk ishte ndonjë ditë e zakonshme ligjëratash apo provimesh, por pikërisht në këtë datë bëhej nisja për një iftar të përbashkët në "Kullën e jetimit" në Prevallë. Ky ishte një iftar në kuadër të aktiviteteve të Organizatës "Paqja Studentore". Nisja nga Prishtina u bë me dy autobusë. Edhe pse ishte rrugë e gjatë dhe koha me temperaturë të lartë, atmosfera gjatë udhëtimit ishte e këndshme, e përcjellë me bashkëbisedime të shumta, këndim të ilahive, etj.

Posa arritëm në Prevallë, natyra, ajri i pastër dhe bukuritë e atij vendi na magjepsën. Derisa ne lëviznim në kopshtin e madh dhe shijonim bukuritë e pafundme të tij, pronari dhe stafi punues i restorantit vraponin si bletët duke u përgatitur për të shtruar iftarin për 100 mysafirët që kishin ftuar.

Iftari ishte shumë i begatshëm dhe përbëhej nga lloje të ndryshme ushqimesh. Pas faljes së përbashkët të namazit të akshamit, Hysni Mustafa, kryetar i Paqes Studentore, i përshëndeti të pranishmit. Ai, po ashtu, e falënderoi pronarin e restorantit për ftesën dhe për mikpritjen. Më pas fjalën e mori pronari i restorantit "Kulla e jetimit", zotëri Kemajl Jonuzi, i cili shprehu gëzimin që "Paqja Studentore" i ishte përgjigjur, në mënyrë aq të organizuar, ftesës për këtë iftar. Duke shprehur emocionet që gjendej para një numri aq të madh studentësh, të cilët, përveç që kishin prioritet mbarimin e studimeve, nuk linin anash kryerjen e obligimeve fetare, ai tha: "Më besoni që ka një kohë shumë të gjatë që nuk jam ndier kështu, i emocionuar, që gjendem para jush, para një shtrese njerëzish me vlera të mëdha. Ju i keni caktuar vetes të ecni drejt një rruge të gjatë e të begatshme, e cila nuk mbaron asnjëherë deri në vdekje. Me pak fjalë, ashtu siç ju pashë sot, më keni dhënë shpresa të mëdha dhe ma keni shtuar imanin".




Mbrëmja në "Kullën e jetimit" u bë më madhështore kur Nasuf Gashi recitoi pjesë nga Kur'ani. Po ashtu, Pajtim Ademi këndoi një ilahi, të cilën e kishte shkruar vetë. Ndenjja në Prevallë vazhdoi deri vonë, në kopshtin e bukur të restorantit, duke bashkëbiseduar me pronarin dhe stafin e tij, të cilët u treguan shumë të afërm me studentët. Edhe pse nuk u ngopëm duke qëndruar në atë ambient të bukur, pas përshëndetjes së ngrohtë me nikoqirin e asaj mbrëmje, u nisëm për në qytetin universitar, në të cilin na prisnin obligimet e shumta, ku përfshihet edhe ky memoar për atë ndenjje. ■



# Ne dhe Evropa

Osman D. GASHI

Në ambientin e bukur të sallës së Teatrit Profesional "Jusuf Gërvalla" në Pejë, më 16 shtator, O.J.Q. Horizonti i Diturisë, organizoi tribunën "Ne dhe Evropa", në të cilën ligjëruan prof. dr. Milazim Krasniqi dhe mr. Enes Goga.

Pas shpalosjes së një prezantimi të kësaj O.J.Q.-je, ku u tregua për veprimtarinë dhe aktivitetin e saj, më pas iu dha fjala mysafirit nga Prishtina, prof. dr. Milazim Krasniqi që ta trajtojë temën nga aspekti socio-politik.

Prof. Krasniqi në ligjërimin e tij, ndër të tjera vuri në theks se shqiptarët janë pjesë e Evropës si gjeografikisht ashtu edhe kulturalisht në esencë janë evropian. Ai gjithashtu tërhoqi paralelen se ne jemi edhe muslimanë edhe evropian dhe konsiderohemi si një urë lidhëse dhe komunikuese mes Lindjes dhe Perëndimit.

"Ne jemi edhe mysliman edhe evropian, e gjithashtu jemi urë lidhëse mes Lindjes dhe Perëndimit. Identitetin tonë evropian e determinon gjeografia dhe duhet që të kemi kujdes që askush mos të na injektojë ndjenjën e inferioritetit se kinse ne (shqiptarët) jemi më pak evropian se sa tjerët. Ne, edhe nga pikëpamja kulturore, pra, kultura shqiptar thellësisht është në esencë evropiane", theksoi ndër të tjera Krasniqi.

Ai gjithashtu foli edhe për gjendjen e tanishme të shoqërisë sonë e cila sipas Krasniqit ndodhet në një krizë morale, duke bërë thirrje për ribërjen e këtij virtyti, vetëdijesimin e shoqërisë sonë për ndërtimin e një shteti funksional dhe përgatitjen e një shoqërie konkurrente karshi popujve tjerë të Evropës. "Shoqëria jonë është në krizë morali, duhet ta ribëjmë moralin, shtetin funksional, duhet që të jemi një shoqëri vërtet tolerante, të përgatitemi për një konkurrencë të fortë por me vlerat tona që i posedojmë. Shqiptarët duhet të jenë model edhe i tolerancës fetare", shtoi në fund prof. Krasniqi.

Ndërsa ligjëruesi i dytë, mr. Enes Goga, temën e shtjelloi nga pikëpamja profesionale Islame, ku vuri në theks të veçantë se Islami nuk mund të jetë pengesë për Evropën, dhe se Islami ka konsideratë për ndjenjat njerëzore, është fe e drejtësisë, ka koherencë për çdo kohë dhe vend, Islami është fe që porositë për përsosjen etike, garanton lirinë por jo abuzimin në emër të lirisë e në anën tjetër ligjëruesi Goga vlerësoi se inkuadrimi ynë në Bashkimin Evropian nuk duhet të nënkupton shkrirje apo asimilim, por konkurrim me vlerat tona që i posedojmë si shqiptarë në njërën anë dhe si muslimanë në anën tjetër.

Më pas u hap debati, ku me pyetje u paraqitën disa të pranishëm.

Ky organizim ishte në kuadër të aktiviteteve të shumta që kjo O.J.Q. ka realizuar gjatë muajit të bekuar të Ramazanit. ■








Shoqata kulturore "Zëri Ynë" në bashkëpunim me KBI-në, dega Rahovec, kanë organizuar tribunën "Ramazani - muaj i ndryshimeve" në të cilën ligjëruan: prof. dr. Milazim Krasniqi, dr. Ferid Agani dhe Nysret ef. Abazibra - kryeimam i Rahovecit. Në këtë aktivitet u shtrua edhe një iftar për të pranishmit.

Zëri Ynë
SHOQATA KULTURORE



# Ahtisari: Pranimi i Turqis

**Fituesi i çmimit Nobel, Marti Ahtisari, bën përpjekje për zgjerimin e BE-së, thërret për investime në Kosovë dhe kërkon më shumë hapësirë për imigrantët drejt BE-së.**

**Wolfgang BÖHM**
(DIE PRESSE)

**"DIE PRESSE":** ***Jeni dukur i frustruar në Alpbach për shkak se që me gjithë përpjekjet tuaja të mëdha, grupet etnike në Ballkanin Perëndimor po shkojnë ende shumë ngadalë drejt një përafrimi ndërmjet vete. A do të munden ndonjëherë që shtetet si Kosova të vazhdojnë rrugën e tyre pa mbikëqyrjen ndërkombëtare?***

**Marti Ahtisari:** Po do të munden. Vetëm se, prioriteti më i madh për një gjë të tillë duhet të jetë plotësimi i kushteve për zhvillimin e ekonomisë. Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore e kanë kuptuar këtë gjë. Tani shpresoj që këtë shembull do ta ndjekin edhe institucionet financiare evropiane. Njëra prej mundësive për zhvillimin e Kosovës është sektori energjetik. Kosova me rezervat e saj të mëdha të thëngjillit, do të mund të bëhej një furnizues i rëndësishëm i energjisë. Kurse të rinjve patjetër duhet t'u krijohen vende pune, përndryshe shumë prej tyre rrezikohen të zhyten në kriminalitet. Gjithashtu, duhet të vazhdojë puna për ngritjen e administratës. Ndërsa sa i përket problemit etnik: Serbët sikurse edhe kosovarët duhen të përkujtohen se asnjëherë nuk do të mund të bëhen anëtarë të Bashkimit Evropian, nëse nuk arrijnë të jetojnë bashkë në paqe.

**"DIE PRESSE":** ***A duhet që pranimi i pavarësisë së Kosovës nga Serbia të jetë kusht që ajo të fitojë të drejtën e kandidatit për t'u bërë anëtare e BE-së?***

**Ahtisari:** Serbët nuk guxojnë të 'minojnë' pavarësinë e Kosovës. Ne nuk duhet të pranojmë që të marrim mbi supet tona probleme të tilla. Ne veç e kemi problemin e Qipros, gjithashtu edhe mosmarrëveshjen ndërmjet Sllovenisë dhe Kroacisë për çështjen e kufirit.

**"DIE PRESSE":** ***A mundet Bashkësia Evropiane t'i zgjidhë të gjitha problemet? Në shembullin që ju e përmendet për Qipron, BE-ja nuk ia ka dalë dot mbanë. Kurse, deri më sot, pranimi i saj në BE nuk ka ndikuar të ndryshojë asgjë në ishullin e ndarë.***

**Ahtisari:** Sigurisht që kjo e zvogëlon besueshmërinë tonë si organizatë ndërkombëtare. Kur ne nuk jemi në gjendje t'i zgjedhim problemet tona, atëherë si mund t'i ndihmojmë dikujt tjetër? Unë e kam thënë edhe në fjalimin tim për çmimin Nobel se nuk duhet të pranojmë ngrirjen e konflikteve, por ne duhet t'i zgjidhim këtë probleme.

**"DIE PRESSE":** ***Në disa vende të BE-së është duke u shfaqur një rezistencë kundër vazhdimit të zgjerimit të Bashkimit Evropian. Për shembull, Partia Gjermane CDU kërkon ndaljen e pranimit të Kroacisë. Kërkesa të ngjashme vijnë edhe nga Franca edhe nga Austria. A do të këtë kjo pasoja në përpjekjet për***



# së në BE nuk bart rreziqe



*paqe në regjionet si për shembull ai i Ballkanit Perëndimor?*

**Ahtisari:** Po, edhe kjo gjithashtu rrezikon të rrënojë besueshmërinë tonë. Mos të harrojmë, ne e kemi rregull që të gjitha shtetet që i plotësojnë kushtet mund të bëhen anëtare (të Bashkimit Evropian). Me rastin e Turqisë, kur u zhvilluan bisedimet për pranimin e saj, të gjithë ishin të një zëri; tash duhet t'i përmbahemi kësaj.

**"DIE PRESSE":** ***Domethënë ju jeni për anëtarësimin e Turqisë në BE. Por a mund ta kuptoni dhe shpjegoni përse ka kaq shumë njerëz që janë skeptikë?***

**Ahtisari:** Unë pyes veten, si mund të krijojmë marrëdhënie normale me shoqërinë islame, derisa ne nuk jemi në gjendje që t'ia hapim dyert për anëtarësim një shteti si Turqia? Sigurisht se flas si njëri drejt vendit të të cilit graviton një numër shumë i vogël emigrantësh. Por problemi me siguri është shfaqur atëherë kur njerëzit janë pranuar pa ua bërë me dije se ata duhet edhe të integrohen. Mua më kujtohen përllogaritjet e viteve 90-të, kur BE-ja, në atë kohë vetëm me 15 shtete anëtare, kishte nevojë për 1,4 milion imigrantë si fuqi punëtore. Ndërkohë kjo shifër është rritur edhe më shumë. Ne duhet të mësohemi të jetojmë me të huajt. Përndryshe, ne nuk do të mund të mbajmë së funksionuari sistemet tona shëndetësore, kujdesin për të moshuarit tonë dhe shumëçka tjetër.

**"DIE PRESSE":** ***Dhe për këto arsye ne kemi nevojë për anëtarësimin e Turqisë?***

**Ahtisari:** Sigurisht se po. Ne duhet ta kemi të qartë se tanimë ekziston një garë internacionale për emigrantët dhe se tani është më se e nevojshme që kjo të realizohet nga ana jonë.

**"DIE PRESSE":** ***Ju, në ditët në vijim, do të dorëzoni një raport si shenjë e pjekjes së kushteve për anëtarësimin e Turqisë. A shihni edhe rreziqe në këtë pranim?***

**Ahtisari:** Pranimi i Turqisë nuk sjell aspak rreziqe. Përkundrazi, unë shoh përparësitë: Turqia, në përpjekjet e ardhshme, mund të luajë një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e konfliktit të Lindjes së Mesme. Shoqëria turke ka arritur ndryshime pozitive. Ekonomia është rritur. Mbi të gjitha, përmes këtij raporti, ne dëshirojmë t'i kontribuojmë një debati frytdhënës. Ne kemi përfituar prej secilit anëtarësim që kemi pasur. Shikoni vetëm rastin e Irlandës.

**"DIE PRESSE":** ***Por Turqia është një vend shumë herë më i madh (se Irlanda). Ajo ka 70 milionë banorë. A nuk po provokojmë ne me këtë gjë një përzierje etnike dhe kulturore në BE, për të cilën nuk jemi aspak të përgatitur? Dhe pikërisht shembulli i Ballkanit Perëndimor tregon se sa vështirë është të organizosh një bashkëjetesë të tillë.***

**Ahtisari:** Sikur shtetet e tilla si këto nuk do ta kishin shpresën për hyrjen në BE, problemet do t'i kishin shumë më të mëdha. Por edhe ne duhet ta kemi të qartë se, pa këto shtete, as ne nuk do të mund ta mbajmë të lartë standardin tonë të jetesës.

**"DIE PRESSE":** ***Por si do të mund t'i bindni qytetarët skeptikë të BE-së për këtë gjë?***

**Ahtisari:** Nuk jam pesimist për këtë gjë. Kur shfaqet një nevojë, atëherë njerëzit do ta kuptojnë. Ne nuk guxojmë që thjesht për një çështje kaq të rëndësishme si kjo, të lejojmë që masa e gjerë të na drejtojë në rrugë të gabuar. ■

Përktheu dhe përshtati:
**Avni Xhemajli**

**Marti Ahtisari** ka ndërmjetësuar në shumë konflikte, si për shembull në Namibi, Indonezi dhe Ballkan (Kosovë). Në vitin 2008 ish-presidenti i Finlandës fitoi çmimin Nobel për paqe. Së fundi, Ahtisari për herë të parë mori pjesë në bisedimet politike në Forumin e Alpbach-it, ku edhe u zhvillua kjo intervistë.

# Prerja e artë – Masa e bu

**Fakti se një pjesë e madhe e strukturave të gjalla apo jo të gjalla janë formuar sipas një formule specifike matematike tregon edhe një herë natyrën superiore të krijimit të Zotit tonë. Çdokush që përsiat mbi mjeshtërinë artistike krijuese të pakrahasueshme të Zotit tonë dhe që i shqyrton shembujt përreth tij në dritën e koshiencës së tij do ta shohë këtë të vërtetë të qartë**

Mimoza SINANI

Çfarë kanë të përbashkët piramidat e Egjiptit, portreti i Mona Lizës së Leonardo da Vinçit, kërmilli, boça e pishave dhe gishtat tuaj?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje qëndron e fshehur në një varg numrash të zbuluar nga matematikani italian, Leonardo Fibonaçi: 0, 1, 1, 2, 3, 5, 8, 13, 21, 34, ... Karakteristikë e këtyre numrave, që njihen si numrat e Fibonaçit, është se secili prej tyre është i barabartë me shumën e dy numrave paraardhës.


Numrat e Fibonaçit kanë një veçori interesante. Kur ju e pjesëtoni një numër të vargut me numrin përpara tij, ju përftoni numra që janë tepër afër njëri-tjetrit. Në fakt, pas numrit të trembëdhjetë të vargut ky numër (që është i barabartë me 1.618) fiksohet dhe njihet si "Prerja e artë".


Ligji i prerjes së artë u studiua thellësisht në shkollat e antikitetit grek, sidomos në të Pitagorës dhe u përdor gjerësisht në projektimin e komplekseve arkitekturore, objekteve të kultit, në kompozimin e statujave, siç shihet edhe në statujën e Apollonit.

## Prerja e artë dhe trupi i njeriut

Gjatë kërkimeve apo krijimtarisë së tyre, artistët, shkencëtarët dhe disenjatorët, marrin si masë të tyre trupin e njeriut, proporcionet e të cilit janë vendosur sipas prerjes së artë.

Leonardo da Vinçi dhe Le Korbusier e përdorën këtë prerje në vizatimet e tyre. Trupi njerëzor, proporcional sipas prerjes së artë, merret gjithashtu si bazë në librin 'Neufert', një nga librat më të rëndësishëm të referencave të arkitektëve të kohëve moderne. Ndërmjet pjesëve të ndryshme të trupit njerëzor ekzistojnë relacione proporcionale "ideale" që janë gjithmonë ekuivalent me vlerën e prerjes së artë: 1.618. Shkencëtarët dhe artistët pajtohen se këto relacione vlejnë për "formën e idealizuar njerëzore".


Prerja e Artë e Fibonaçit



Disa proporcione të arta në trupin mesatar njerëzor janë:

*-Largësia ndërmjet majës së gishtit dhe bërrylit / largësia ndërmjet kyçit dhe bërrylit.*

*-Largësia ndërmjet vijës së supit dhe majës së kokës / gjatësia e kokës.*

*-Lagësia ndërmjet kërthizës dhe gjurit / largësia ndërmjet gjurit dhe fundit të këmbës.*

*- Përpjesëtimi i dy ndarjeve të para të gishtit me gjatësinë e plotë të gishtit. [Kjo nuk vlen për gishtin e parë me dy nyje.]*

*-Përpjesëtimi i gishtit të mesëm më gishtin e vogël është gjithashtu një prerje e artë.*

*- Gjerësia e plotë e dy dhëmbëve të sipërm në nofullën e sipërme përmbi lartësinë e tyre jep një prerje të artë.*

*- Gjerësia e dhëmbit të parë nga qendra përmbi gjerësinë e dhëmbit të dytë jep gjithashtu një prerje të artë.*

*-Gjatësia e fytyrës / gjerësia e fytyrës.*

*-Largësia ndërmjet buzëve dhe bashkimit të vetullave / gjatësia e hundës.*

*-Gjatësia e fytyrës / largësia ndërmjet majës së nofullës dhe vendit ku bashkohen vetullat.*

*-Gjatësia e gojës / gjerësia e hundës,*

*-Gjerësia e hundës / largësia ndërmjet flegrave të hundës.*

*-Largësia ndërmjet bebeve të syrit / largësia ndërmjet vetullave.*

*- Proporcioni i bronkut më të shkurtër, që përbën mushkëritë, me atë më të gjatë është gjithmonë 1/1.618*

I gjithë ky informacion na tregon edhe një herë natyrën superiore të krijimit të Zotit tonë, i Cili në krijimin e Tij përsosi e orientoi dhe formësoi ashtu siç dëshiroi (Kuran 82:7,8)

## Drejtkëndëshi i artë dhe spiralet

Drejtkëndëshi brinjët e të cilit janë 1 dhe 1.618 njësi të gjata është një drejtkëndësh i artë. Le të marrim një katror që ka gjatësinë e brinjës së shkurtër të këtij drejtkëndëshi dhe vizatojmë një çerek rrethi midis dy anëve të katrorit. Më pas, le të vizatojmë një katror dhe një çerek rrethi në brinjën tjetër dhe le ta bëjmë këtë për të gjitha drejtkëndëshat që mbeten në drejtkëndëshin kryesor. Kur ta bëni këtë ju do të përfundoni me një spirale. Spiralet që bazohen mbi prerjen e artë përmbajnë strukturat më të pakrahasueshme që mund të gjeni në natyrë. Shembujt e parë që mund të japim për këtë janë radhët spirale mbi luledielIin dhe boçën e pishës.

## Prerja e artë dhe struktura e guaskës së detit

Format e guaskës së molusqeve të mahnitin me perfeksionin e tyre dhe leverdisshmërinë e mënyrave të përdorura për krijimin e tyre. Ideja e spirales te guaskat shprehet në formë perfekte gjeometrike, në një dizajn "të mprehtë" me bukuri mahnitëse.

Guaskat e pjesës më të madhe të molusqeve rriten në mënyrë spirale logaritmike. Rritja e këtij lloji u përsh-

# kurisë e krijuar nga Zoti

krua si "gnomike". Rritja e një guaske bazohet mbi zgjerimin dhe shtrirjen në forma me proporcione identike dhe të pandryshueshme. Guaska, rritet vazhdimisht, ndërsa forma mbetet e njëjtë.

Sigurisht, nuk ka dyshim se këto kafshë janë të pavetëdijshme madje edhe për llogaritjet më të thjeshta matematike, e jo më për spiralet logaritmike.

Prandaj, si është e mundur që krijesat në fjalë kanë mundur të dinë që kjo është mënyra më e mirë për t'u rritur?

Si kanë arritur këto kafshë, që disa shkencëtarë i përshkruajnë si "primitive", të dinë se kjo është forma ideale për to? Është e pamundur që rritja e këtij lloji të ndodhë në mungesë të një vetëdijeje ose intelekti. Kjo vetëdije nuk ekziston as te molusqet, as te vetë natyra, pavarësisht se çfarë pretendojnë disa shkencëtarë.

Është plotësisht joracionale të kërkosh që të llogaritësh një gjë të tillë në kushtet e rastësisë. Kjo strukturë mund të jetë vetëm produkt i një intelekti dhe dijeje superiore.

Forma spirale nuk është e kufizuar në mbretërinë e kafshëve vetëm për guaskat e molusqeve. Brirët e kafshëve të tilla si antilopa, dhia e malit dhe dashi, gjithashtu rriten në spirale që bazohen mbi prerjen e artë.

Shembujt e lakoreve që bazohen në spiralen logaritmike mund të shihen edhe në dhëmbët e elefantëve dhe mamuthëve tashmë të zhdukur, në dhëmbët e luanëve dhe sqepin e papagajve. Merimanga Eperia gjithmonë e end rrjetën e saj sipas një spiraleje logaritmike. Mjaft mikroorganizma të njohura si planktone janë të ndërtuara sipas spiraleve. Amonitet, të cilat sot janë zhdukur dhe gjenden vetëm në formë fosilesh, gjithashtu kanë guaska që rriten në mënyrë logaritmike.

Në një ajet të Kur'anit tregohet se si Zoti sundon mbi të gjitha gjërat me njohjen e Tij superiore dhe se njerëzit duhet të përsiatin mbi mjeshtërinë artistike krijuese të pakrahasueshme të Zotit tonë (Kuran, 6:80)




## Prerja e artë në ADN

Molekula e ADN-së, në të cilën ruhen të gjitha tiparet fizike të qenieve të gjalla, gjithashtu është krijuar në një formë që bazohet në prerjen e artë. ADN përbëhet nga dy spirale pingule të ndërthurura.


Gjatësia e lakores në secilën nga këto helika është 34 angstromë dhe gjerësia është 21 angstromë (1 angstromë është një e njëqind milionta pjesë e një centimetri.) 21 dhe 34 janë dy numra të njëpasnjëshëm të Fibonaçit.

I gjithë ky informacion është vetëm një provë e rëndësishme se universi u krijua nga një inteligjencë sublime, me fjalë të tjera, Zoti e krijoi universin dhe të gjitha gjërat në të nga asgjëja.

Në Kuran Zoti i fton besimtarët që të mendohen për këtë dëshmi. Çdokush që shqyrton shembujt përreth tij në dritën e koshiencës së tij, do ta shohë këtë të vërtetë të qartë. Në Kuran është shprehur perfeksioni i mjeshtërisë artistike krijuese të Zotit, ku nuk mund të vërehet asnjë kontrast (Kuran 67: 3-4).

## Prerja e artë në botanikë

Ndonëse degët që shohim në pemët përreth nesh mund të duken në shikim të parë se janë vendosur rastësisht, ato në të vërtetë janë të vendosura sipas një plani dhe llogaritjeje matematikore jashtëzakonisht të ndërlikuar. Rregulli se si renditen gjethet përreth kërcellit



përcaktohet sipas numrave të veçantë.

Kjo renditje bazohet mbi një llogaritje jashtëzakonisht të ndërlikuar. Pika ku do të shfaqet çdo degë, vijimësia e gjetheve në degë dhe madje format simetrike te lulet, të gjitha janë të vendosura sipas ligjeve të pandryshueshme dhe madhësive të mrekullueshme. Gjethet janë të renditura ashtu që të mos hedhin hije mbi njëra-tjetrën. Çdo bimë ka degëzimin e vet unik dhe ligjet e vijimësisë së gjetheve.

Ekzistenca e përpjesëtimit të një vijimësie të tillë të gjethes është dëshmi e rëndësishme se gjërat e gjalla nuk janë krijuar rastësisht, por se ato janë krijuar me një strukturë jashtëzakonisht të ndërlikuar.

Botanistët kanë identifikuar numrat e brendshëm të prerjes së artë në degëzimin e një bime që rritet. Pasi bima rritet, nga çdo syth shfaqet një degë e re dhe nga çdo degë e re shfaqet edhe një degë e re. Vargu i Fibonaçit është një çelës kyç për të kuptuar llogaritjen dhe renditjen e stërholluar te bimët. Fakti se bimët formohen sipas një formule të veçantë matematikore, është një nga dëshmitë më evidente se ato janë krijuar në mënyrë të veçantë.

Dëshmi të tjera të krijimit që përfshijnë prerjen e artë gjenden edhe në disa lule, fara dhe fruta. Luledielli është një nga shembujt më të bukur për këtë temë. Nëse ju filloni të numëroni të gjitha farat në spirale të lulediellit, duke u rrotulluar nga e djathta në të majtë, ju do të gjeni dy numra të njëpasnjëshëm nga vargu i Fibonaçit. Kjo sigurisht nuk kufizohet vetëm për lulediellin.

Luleshqerrat dhe luspat e boçave të pishave janë të vendosura gjithashtu në spirale nga e djathta në të majtë. Nëse ju i numëroni këto një nga një, ju do të merrni numrat që bazohen në vargun e Fibonaçit, me fjalë të tjera, në prerjen e artë.

Bimët iu janë përmbajtur këtyre ligjeve me përpikëri, që nga momenti që ato u krijuan së pari. Me fjalë të tjera, asnjë gjethe ose lule e vetme nuk shfaqet rastësisht. Sigurisht, nuk mund të jetë rastësia ajo që i krijon të gjitha bimët me llogaritjet e tyre unike matematikore. Krijuesi i kësaj forme të bukur dhe të përsosur është Zoti i Gjithëditur, i Cili krijoi çdo gjë, duke e përsosur në mënyrë të qartë (Kuran, 25: 2).

Është Zoti i Gjithëfuqishëm dhe i Gjithëditur që e kodoi një proporcion të tillë në strukturën gjenetike të gjërave të gjalla dhe i krijoi ato me këtë informacion.

## Prerja e artë në format gjeometrike

Format gjeometrike nuk janë aspak të kufizuara për trekëndëshat, katrorët, pesëkëndëshat ose gjashtëkëndëshat.

Këto forma mund të bashkohen gjithashtu në mënyra të ndryshme dhe të prodhojnë forma të reja gjeometrike tredimensionale.

Kubi dhe piramida janë shembujt e parë që mund të përmenden. Megjithatë, përveç këtyre, ekzistojnë gjithashtu forma të tilla tredimensionale si katërfaqëshi, gjashtëfaqëshi, tetëfaqëshi, dymbëdhjetëfaqëshi dhe njëzetfaqëshi. Shkencëtarët kanë zbuluar se këto forma mund të shndërrohen matematikisht të gjitha te njëra-tjetra dhe se ky transformim ndodh sipas përpjesëtimeve që lidhen me prerjen e artë.

Format tredimensionale që përmbajnë prerjen e artë janë shumë të përhapura te mikroorganizmat. Dymbëdhjetëfaqëshi dhe njëzetfaqëshi gjithashtu shfaqen në strukturën e radiolarianëve, organizmave detare njëqelizore.

Strukturat që bazohen mbi këto dy forma gjeometrike, përbëjnë trupat e bukur dhe të larmishëm të radiolarianëve.

## Prerja e artë në fjollat e borës

Prerja e artë manifestohet gjithashtu edhe në strukturat kristalore. Pjesa më e madhe e tyre janë në struktura tepër të vogla për t'u parë me sy të lirë. Por ju mund ta shihni prerjen e artë te fjollat e borës.

Llojshmëritë e ndryshme, të gjata dhe të shkurtra dhe zgjatimet që përbëjnë fjollat e borës, japin që të gjitha prerjen e artë.

## Prerja e artë në fizikë

Vargu i Fibonaçit dhe prerja e artë haset edhe në fushat që hyjnë në sferën e fizikës.

Kur mbi dy shtresa qelqi të ngjitura mbahet një dritë, një pjesë e kësaj drite depërton, një pjesë thithet dhe pjesa tjetër reflektohet. Ajo që ndodh është një "pasqyrim i shumëfishtë". Numri i rrugëve që merr rrezja brenda qelqit, përpara se të shfaqet sërish, varet nga numri i pasqyrimeve që ajo i nënshtrohet. Si përfundim, kur ne përcaktojmë numrin e rrezeve që rishfaqen, ne zbulojmë se ato janë të përputhshme me numrat e Fibonaçit.

## Preja e artë dhe Meka

Kohët e fundit është zbuluar se edhe raporti i distancës së Mekës në rruzullin tokësor ndërmjet dy poleve i përgjigjet prerjes së artë. Largësia e Mekës nga Poli i Jugut/ Largësia e Mekës nga Poli i Veriut = 12348.32 km/7631.68 km= 1.618

## Prerja e artë është krijim i Zotit

Fakti se një pjesë e madhe e strukturave të gjalla ose jo të gjalla, të shkëputura nga njëra-tjetra në natyrë, janë formuar sipas një formule specifike matematikore, është një nga dëshmitë më të qarta se këto janë krijuar në mënyrë të veçantë. Zoti na thotë në Kuran se Ai ka krijuar të gjitha gjërat me masë (Kuran, 65:3; 13:8). ■





# 'Njeri nuk bon shpin e vet me vjedh!'



Halil ASLLANI

*Kush jan kta njerz qe s'jan shkollue, nuk kan msu qe njeri nuk bon shpin e vet me vjedh?* Është ky një varg i këngës 'Amaneti i clownit' kënduar nga rok grupi i njohur muzikor Troja. Është një varg që nën tingujt e muzikës shpalos mllefin dhe zemërimin e akumuluar te qytetari i rëndomtë dhe i pafajshëm ndaj këtyre njerëzve që na kanë në dorë. Është një varg që të prek në zemër dhe të sjell në mendje dëshpërimin. A thua pse këta njerëz vjedhin shtëpinë e vet? Pse këta njerëz nuk ndalen të mendojnë e ta kuptojnë se kanë hyrë në një rrugë të gabuar e të errët? Në një rrugë që nuk dërgon askund tjetër përveçse në humbje e dështim. Janë këta njerëz që rrejnë e mashtrojnë zgjedhësit e tyre vetëm e vetëm që të jenë aty ku mund të vidhet, aty ku i hapet gryka thesit shumë të dashur e të respektuar nga ta.

Aty ku e gjejnë veten të përkushtuar vetëm pas asaj të keqes, aty ku krijojnë rrethin e vet, rreth të cilit më pas janë të përkushtuar që ta mbrojnë në çdo mënyrë, vetëm për t'u ngopur së bashku nga ajo që nuk të lë kurrë të hapësh sytë e të shohësh dritën e diellit dhe që nuk të lë të ecësh në një hap me kohën. Rreth në të cilin mbizotëron padrejtësia, rreth në të cilin nuk lejohet që të depërtojë mendja e ndritur dhe kështu i dërgon ata drejt pafundësisë.

Kur do të mbledhim mend, siç thotë populli, dhe të hipim në trenin e kohës drejt destinacionit të duhur dhe kështu të shohim me sytë tanë dhe të shijojmë të mirat që ka çdo shoqëri përparimtare? Të krijojmë një kulturë udhëheqjeje me të cilën nesër do të krenoheshim dhe nuk do të ndiheshim keq kur t'i thoshim dikujt se 'jam shqiptar', përkundrazi do të mburreshim.

Jemi ne, populli, ata zgjedhësit e tyre që po e pësojmë më së shumti. Jemi ne ata që çdo ditë dëgjojmë padrejtësi, parregullsi, gjëra që mbjellin zhgënjimin dhe demotivimin e qytetarit që të japë kontributin e tij në të mirë të këtij vendi. Ne duhet të jemi ata që t'i themi jo të keqes, të padrejtës e të shëmtuarës dhe ne jemi ata që duhet të orvatemi të bëjmë një ndryshim pozitiv, nëpërmjet të cilit do t'i afroheshim botës dhe shoqërisë së civilizuar. Fatkeqësisht, në vendin tonë të dashur ku po jetojmë, vështirë është ta shprehësh publikisht zhgënjimin që është grumbulluar ndër vite. Është vështirë sepse mund ta pësosh keq po ta thuash në mënyrë të drejtë realitetin me të cilin bashkëjeton. E kjo do të ketë pasoja, ashtu sikurse ka pasur e si duket do të ketë edhe për një kohë të gjatë. Gjendja e një populli nuk ndryshon vetë, përderisa ata nuk ndryshojnë. E kur do të fillojë ky ndryshim? Kur do të thonë 'mjaft më' këta njerëz që po vjedhin shtëpinë e tyre? Kur do ta kuptojnë këta njerëz se nuk bëhesh kurrë shtëpi nëse vjedh vetveten? Kur do ta lënë anash dëshirën e madhe që kanë për të vjedhur, dëshirë e cila fatkeqësisht po funksionon mirë në rrethin të cilin e kanë krijuar këta njerëz, pra një dëshirë që po përcillet në gjenerata dhe që po formon një zinxhir që t'i lidh këmbë e duar e nuk të lë kurrë të dalësh në dritën e diellit?

E kur do të jetojmë në një shtëpi ku secili anëtar do të punonte dhe do të jepte kontributin e tij ose të saj, në një shtëpi të cilën shumëkush do ta kishte zili e lakmi, në një shtëpi ku do të ndiheshe i privilegjuar, e në të njëjtën kohë do të ndiheshe krenar dhe kryelartë që jeton në të. Në një shtëpi e cila do të bëhej model për shumë fqinj të tjerë dhe në të cilën do të kishte dëshirë të jetonte çdo njeri. Në një shtëpi ku me mburrje do t'i thoshim mikut, shokut, e qe besa edhe armikut: 'ja kjo është shtëpia ime në të cilën jetoj'. Kjo është shtëpia ime, të cilën e kam ndërtuar me djersë, të cilën do ta ruaj dhe do ta mbroj.

Kjo është shtëpia të cilën do ta trashëgojnë brezat e ardhshëm, breza që nuk vjedhin, por që e ndërtojnë dhe e pasurojnë shtëpinë e vet. ■

# Fati i një studenti



Iljasa SALIHU

Kryesisht, profilizimi i nxënësve fillon menjëherë pas mbarimit të shkollës së mesme. Paralelisht me profilizimin fillojnë, edhe brengat për të ardhmen. Preokupimi kryesor i nxënësve në vitin e fundit është përcaktimi për profesionin e ardhshëm! Bëhen shumë konsultime me njerëz të ndryshëm, mbi atë se çka duhet të vazhdojmë më tutje, ose ndokush që në fillim deklarohet se nuk do të vazhdojë më shkollimin. Ndokush e sheh veten në mërgim ose dikush në tregti. Ata që vendosin të vazhdojnë shkollimin nëpër universitete shtetërore, ende pa u regjistruar do të përballen me problemin e të regjistruarit, për të mos thënë këtu edhe është nisma e padrejtësive. Me padurim priten rezultatet dhe me të marrë vesh se është regjistruar, fillon një gëzim i papërshkruar. I saporegjistruari mendon me vete se e ka larguar një brengë, duke harruar se ka hapur derën e brengave të pambarimta. Kur fillon viti i parë, studenti përballet me shumë të papritura, sepse ajo çka e ka menduar më parë, tash nuk i del ashtu. Por, tashmë, disi ambientohet si student. Fillon të bëjë ndryshime graduale, të mendojë ndryshe, të ketë një rreth ndryshe, përgjithësisht iu nënshtrohet ndryshimeve. Synimi kryesor është që ta kryejë fakultetin, por brendapërbrenda studimeve ka edhe shumë nënqëllime të tjera si për shembull: të pasurohet me dituri, të ndjekë kurse të gjuhëve të huaj, të ndjekë trajnime të ndryshme, të jetë i rregullt në ligjërata, të jetë i sinqertë me kolegët, e shumë gjëra të tjera dhe në fund ta bëjë rrumbullakimin e tërë asaj që ka studiuar. Ai, gjatë studimeve, bën shpenzime të mëdha. Prindërit e tij bëjnë çmos vetëm e vetëm që djali i tyre ta kryejë fakultetin dhe të punësohet në ndonjë vend pune të mirë. Po ashtu, edhe djali i ka parasysh shpenzimet e bëra dhe nuk dëshiron që prindi i tij më në fund të zhgënjehet, ndaj studenti bën të pamundurën që të dalë një student i ditur, i formuar, si dhe të ketë një rivalitet me diturinë!

Tashmë gjatë studimeve brenga e tij fillon të evoluoj dhe shpresa të pasurohet. Pas përpjekjeve të shumta dhe angazhimit të madh, studimeve u afrohet fundi. Fillon përgatitja e tezës së diplomës dhe më në fund studenti arrin të diplomojë. Ashtu i gëzuar, bëhet manifestimi. Vijnë miq nga më të ndryshmit. E përgëzojnë për diplomimin dhe, sikurse në fillim të regjistrimit, thotë me vete se e largova edhe një brengë të madhe, duke harruar i gjori se pikërisht tash fillojnë brengat serioze. Pas mbarimit të fakultetit familja dhe i diplomuari mendojnë tashmë për punë. Shkojnë në një institucion për t'u lajmëruar se e ka kryer fakultetin, por për çudi, prej këtu fillojnë problemet kryesore me përgjigje negative për punësim. Ajo çka më së shumti i brengos prindërit dhe të diplomuarin është se çdo natë në edicionin e lajmeve ministra të ndryshëm thoshin se kemi shumë nevojë për kuadro me fakultet! Ai vendos që të mos dorëzohet së kërkuari punë dhe shkon te një institucion tjetër. Aty u prit shumë mirë. U tregon se për çka ka ardhur, por pyetja fillestare në atë institucion ishte se cilës parti i takonte? Ai tronditet nga kjo pyetje dhe nuk gjen dot përgjigje. Ata i thanë bëjë një CV dhe të thërrasim (ishte kjo një mënyrë për ta larguar). Ashtu i mallëngjyer, sheh një shok të tij, shok të shkollës së mesme. Ndalen të bisedojnë në lokalin e tij dhe ky i diplomuari i tregon rastin e tij. Shoku i thotë se nëse nuk gjen dot punë le të shkojë tek ai, pasi mund të punojë si shitës dhe të marrë një rrogë prej 120 eurosh. Këto fjalë ishin një goditje e rëndë për të diplomuarin! Ashtu heshtazi largohet dhe shkon në shtëpi. I vetmuar në dhomë, fillon të mendojë për atë se çka po i ndodh dhe i parashtron vetes një varg pyetjesh se ku qëndron problemi që ai nuk mund të punësohet? Shqetësimet sa vijnë e i rriten. Asgjë nuk ndryshonte përpos brengave. Nuk i kishte mbetur skutë pa kërkuar për punë. Nuk i kishte mbetur njeri që nuk ia kishte qarë hallin e, në anën tjetër, universitetet private sa vinin e shumoheshin dhe në fillim të hapjeve solemne rektorët thoshin se vendi kishte nevojë për kuadro, andaj edhe po bëhej hapja e atyre universiteteve private. Kryeministri dilte me premtime për vende të reja pune, e në praktikë nuk bëhej asgjë, përpos disa punësimeve të pakta, edhe ato me lidhje shumë të forta partiake.



Ky fat është fati i shumë studentëve, të cilët kanë diplomuar në drejtime të ndryshme. Është fakt real! Mirëpo, megjithëkëtë, studentët janë ata të cilët bëjnë ndryshime radikale, janë ata të cilët e ngrenë zërin për të vërtetën, ata të cilët i lënë pa fjalë politikbërësit. Studentët janë e tashmja e popullit. Mjaft më me gënjeshtrat e politikanëve që para zgjedhjeve thonë me plotë gojë se, "studentët janë e ardhmja e popullit". Ky pohim i tyre nuk është gjë tjetër veçse marketing politik, nëpërmjet të cilit ata në mënyrë perfide e shfrytëzojnë të tashmen për t'i mashtruar studentët dhe të diplomuarit. Studentët janë njëmend truri i shoqërisë, lokomotiva e shoqërisë, sepse ata ngërthejnë në vete dy komponentë kryesorë: rininë dhe formimin intelektual. ■

# Përballë vetvetes

Mr. Ejup HAZIRI

Je duke qëndruar në kinema dhe në çdo moment pret që filmi, për të cilin ke shkuar, të fillojë. Shikon sallën e kinemasë, e cila është e stërmbushur me njerëz që kanë ardhur për të njëjtin qëllim. Sytë e tyre i janë drejtuar aparatit kinematografik dhe me ëndje të madhe presin fillimin e filmit. Vjen edhe çasti i caktuar dhe në ekran dalin skenat e para të atij filmi. Si do të ndiheshe nëse krejt papritmas fillon një film që do të elaboronte një pjesë të jetës sate, pasi dikush ka bërë përgjime pa dijen tënde? Duke filluar filmi, fillojnë edhe skandalet, marrëzitë dhe mëkatet e tua të vazhdueshme! Shikon ekranin e zmadhuar dhe ja e sheh veten. Vret mendjen se a je në ëndërr apo jo. Ajo që sheh është realitet e jo fantazi. Fshin sytë se mos vallë ato pamje janë pjellë e imagjinatës, por gabon. Posa t'i hapësh sytë skenat skandaloze mbesin të njëjta dhe tashmë bindesh se personi në aparatin kinematografik je pikërisht ti e jo ndokush tjetër. Shikon përreth vetes sa në të djathtë e sa në të majtë dhe ja që gjithë sytë e tyre janë drejtuar nga ti. Ul kokën poshtë nga turpi, fytyra të skuqet, trupi të dridhet nga ajo që sheh, zemërimi të kaplon, ndërsa pulsi i zemrës sate sa vjen e shtohet. Të gjitha ato që i sheh janë veprimet e tua. Ndoshta në momentin e veprimit e ke konsideruar veten të guximshëm, e ndoshta edhe revolucionar. Sheh padrejtësitë e tua karshi të dëmtuarve, zhytjen tënde në nderet e njerëzve, bartjen e gënjeshtrës, përgojimet, premtimet e thyera, mashtrimet e kota, mëkatet e ndryshme, sheh gjithçka madje edhe imtësitë më të vogla, por të tëra këto skena nuk janë të ekzagjeruara, por një realitet i vërtetuar me fakte e dëshmi që tronditin rëndë ndërgjegjen tënde, saqë fjalët sado të fuqishme që janë, prapëseprapë, ato nuk mund ta shprehin gjendjen e atyre çasteve. Shikon poshtë dhe lutesh që të të hapet toka dhe ti të fundosesh në brendësinë e saj. Ndien se toka të është ngushtuar, edhe pse ajo është mjaft e gjerë. Ngre kokën lart dhe lutesh që Zoti të ta marrë shpirtin para se të turpërohesh dhe të poshtërohesh para gjithë asaj turme njerëzish. Por, për çudi, as toka nuk hapet, e as qielli nuk të bie sipër, e as vdekja nuk të merr, edhe pse ti e kërkon atë me ngulm.

Gjërat që dikur ishin në dorën tënde, tashmë janë në dorën e dikujt tjetër dhe, fatkeqësisht, fuqia jote për të stopuar skandalet e tua është një tentativë e kotë dhe krejtësisht e pavlerë. A do të ngrihesh para gjithë atyre njerëzve dhe do të largohesh nga salla e kinemasë apo do të vazhdosh ashtu i turpëruar dhe tepër i dëshpëruar duke shikuar marrëzitë skandaloze të jetës twnde? Nëse ngrihesh, pa dyshim se të gjithë ata do ta drejtojnë shikimin e tyre tek ti, e nëse mbetesh aty, atëherë poshtërimi veç vjen e shtohet. Sigurisht që asnjëra prej këtyre nuk do të duket ndonjë zgjidhje, madje që të dyja të duken si një ekuacion algjebrik, por para vetes nuk ke ndonjë rrugëdalje tjetër.



Shikon orën dhe mendon se akrepat janë ndalur në tërësi dhe se ajo fare nuk lëviz. Koha të duket e gjatë dhe ato inserte filmi të duken sikur ti je ulur aty me vite, e ndoshta edhe me dekada.

Shqetësimet e brendshme janë të papërshkruara. Brengat, mundimet, mërzitjet e mëdha, ngushtimet e tepërta, hallet dhe sikletet, janë vetëm disa prej atyre që do të shoqërojnë në ato momente të vështira dhe kritike.

Mendon se si do të vijë fundi, por fundi është larg dhe për të arritur deri te fundi, duhet kohë dhe durim i madh për përballimin e atyre shqetësimeve të mëdha.

Ky ishte një përfytyrim imagjinar që mund të ndodhë edhe në realitet, por ky përfytyrim imagjinar i ngjan një dite tjetër që është realitet dhe pasqyrim real.

Ajo është Dita kur, pas ringjalljes, do të qëndrojmë përballë Zotit në mënyrë që të japim llogari për vetveten tonë. Çdo gjë që e kemi vepruar sa ishim gjallë do të jetë e gatshme para nesh. Do të na paraqitet edhe libri i llogarisë së përpiktë.

Vallë, paramendoje këtë situatë: i ndalur me gjithë njerëzimin, shikon në të djathtë e fundi i njerëzve fare nuk shihet, shikon në të majtë e gjendja është e njëjtë si në anën tjetër. Dielli të është afruar mbi kokë, djersët mbulojnë këmbët e tua, shikimi yt është shumë i mprehtë, shpresa sa vjen e zbehet, shpëtimi kushtëzohet nga libri i dhuruar ose nga mëshira e falur e Krijuesit tënd. Para vetes ke librin tënd në të cilin është regjistruar çdo detaj i jetës tënde. Nuk mund të besosh se tërë ajo që ke vepruar është regjistruar, por nuk mund t'i mohosh faktet. Sheh se asgjë nuk është shtuar, llogaria është e drejtë. Lexon librin tënd, ose më mirë të themi lexon marrëzitë e tua, ndalesh pranë mëkateve, gabimeve dhe marrëzive të tua në jetën e kaluar. Fryma mezi del e gjuha mezi shqipton, fytyra të skuqet kur kalon pranë të këqijave që ke vepruar, këmbët të dridhen dhe mezi të mbajnë, por leximi i atij libri duhet vazhduar.

Çuditesh kur sheh para vetes njerëz të shumtë, që qëndrojnë pranë teje. Gjithë ata kërkojnë dëmshpërblim nga ti. O Zot! Si ma vështirësojnë gjendjen! Por, ndoshta ke harruar se edhe ti ia ke vështirësuar ndokujt gjendjen. Këta të ardhurit janë ata që ti u ke bërë padrejtësi në jetën tënde: ke shpifur kundër tyre, ke nëpërkëmbur nderin e tyre, ke gënjyer, ke bartur fjalë, ke bërë këtë e atë, andaj ata tani kërkojnë dëmshpërblim prej teje. Si do t'ia bësh këtij halli? Ai e di se çka do t'u japësh atyre në ato momente kritike? Do t'ua japësh të mirat e tua. Nëse ato nuk mjaftojnë për të gjithë ata, atëherë do t'ua marrësh atyre të këqijat. Vaj halli për llogarinë tënde në atë Dite të tmerrshme, sa Ditë e gjatë dhe sa e vështirë do të jetë! Dhashtë Zoti të mos jemi prej atyre që atë Ditë do të tmerrohen. ■

# Vdiq veterani dhe eruditi i Islamit, Imam-Hafëz Zihni ef. Ahmedi

**Hasan EMËRLLAHU**



Pas një sëmundjeje jo edhe të shkurtër në Preshevë, ndërroi jetë hoxha, imami dhe hafëzi më i shquar i kësaj treve, Hafëz Zihni ef. Ahmedi. Hafëz Zihniu u lind më 1933 në Preshevë, në një familje me tradita të shquara fetare – kulturore dhe arsimdashëse. Shkollimin fillor dhe atë të mesëm e kreu në vendlindje, ndërsa ixhazetin - studimet e tij i mori pranë doajenit të njohur të trojeve të Anamoravës, myderriz - Hafëz Nexhati ef. Ahmedit. Ky studim zgjati më shumë se 20 vite, por do ta shoqëronte atë deri në vdekje. Ka qenë njohës i mirë i arabishtes, turqishtes, osmanishtes dhe boshnjakishtes, ndërsa tani për tani llogaritet edhe si një nga trungjet e fundit osmane në këto troje, meqë e njihte me përpikëri këtë gjuhë të lashtë. Në moshën 12 vjeçare filloi hafëzllëkun pranë babait të tij, hoxhës dhe diplomatit të shquar Hafëz Lufti ef. Ahmedit dhe nënës së tij mendjemprehtë Hafëz Emine Ahmedi. Me sukses të dalluar e mbaroi këtë mision brenda një kohe shumë të shkurtër, mision i cili do ta shoqëronte gjatë gjithë jetës së tij, deri në vdekje, madje dhe në çastet e fundit të jetës. Prej asaj kohe filloi të punojë imam në xhaminë qendrore të "Ibrahim Pashës" në Preshevë, detyrë të cilën e kreu për 50 vite me përpikëri, deri në moshën e tij të shtyrë. Nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Prishtinë, u shpërblye me shpërblimin "Imam i Dalluar". Veproi dhe punoi në kohën më të vështirë, në kohën e errët të komunizmit duke lënë pranë vetes një sërë veprash dhe aktivitetesh të frytshme fetare. Ishte i vetmi hoxhë, i cili përkundër kërcënimeve, ndjekjeve dhe sharjeve të ndryshme nuk e la pas mësimin e Kur'anit fëmijëve. Nxënësit e tij e përkujtojnë me mall punën e tij të palodhur dhe me bereqet. U shqua edhe për zërin e tij melankolik dhe shumë të bukur. I njihte të gjitha mekamet, këndonte shumë bukur edhe Kur'an, edhe ezan. Gjithashtu, zbatoi me përpikëri dhe përkushtim të madh detyrën e shenjtë të imamit, madje duke u përmendur nga xhemaati i tij se nuk kishte munguar në asnjë namaz të sabahut, qoftë në borë a në shi, në frymë e furtunë. Ishte nga ata imam që gjatë muajit të Ramazanit ua lexoi Kur'anin mukabele të mbyllur. Ishte hafëz, jo vetëm me fjalë por hafëz me vepër dhe mund. Fjala e tij përputhej me vepër. Qe model për të gjithë pasuesit. I qetë, i devotshëm dhe i sjellshëm me të gjithë. Ai u shpërngul për në botën tjetër e la pas vetes një sërë nxënësish që e lexojnë Kur'anin në saje të dijes së tij. Gjithashtu, ai la pas edhe pesë fëmijë të shkolluar, që veprojnë për Islam. Mësoi shumë gjenerata, të cilat kanë kryer tani shkolla të mesme dhe fakultete në universitetet e ndryshme të botës. Hafëz Zihniu u nda nga kjo jetë mu në natën e xhumasë së dytë të muajit të shenjtë - Ramazan dhe u nis për në botën e amshuar, mu në këtë ditë feste për muslimanët. U shua një jetë njeriu, jeta e një vepërmiri. Në popull thuhet: Kur bie një gjethe peme – shuhet një jetë njeriu! E gjethet bien. . . jetë njerëzish shuhen!. . Dhe jeta vazhdon!.. Lamtumirë o hafëz efendi i nderuar! InshAllah me lejen e Zotit, Fuqiplotit e Mëshiruesit, stacioni yt i fundit është xheneti i merituar. ■

*Hasan Emerllahu*

## *Presheva dhimbshëm gjeti qetësinë*

Në mëngjesin e hershëm Presheva dhimbshëm gjeti qetësinë,
Drita e purpurt nga minarja zbriti mbi dhé,
O, Zot, vajti ezani i fundit i tij, përjetë e mori Gjithësinë,
Myzhde për Allahun, dhembje, mall e lot për ne.

Nur i madh mbi të u shkri,
Në qiellin e mëndafshtë shtrihet këndimi i Kur'anit,
Për akrabanë rahmetlinjë, myzhdeli,
Iu shkoi, n'jetën e amshimit, Emiri i ezanit.

Në këtë muaj të rahmetit,
Ditë e xhuma, ditë e qartë për këtë myezin,
Allahu, do ta pranojë si xhenetli,
Kjo është e vërtetë dhe nuk ka dyshim.

Unë, e di se nuk mund t'i bëj as hije këtij alimi,
Sepse drita e tij tash shumë lart ka bërë ballë,
Prej tij, rrahleja, musafi dhe mekami, rreze kujtimi
Më kanë mbetur gjerdan në shpirt, qiri plot mall. . .

Metakritikë

# Diferenca e tekstit



Flamur MALOKU

**Rrjetet shpallen, ndërsa përvoja me tekstin gjithnjë shkon dhe shemb kohë e hapësira. Pra, thyhen kufijtë e skemës kohë/hapësirë. Duke u thyer kjo skemë, hetimi zgjatet nëpër variante të filozofisë së interpretimit**

## Njohje/Diferencime

Libri studimor *Udha kratilike* i Nysret Krasniqit hap udhën e kërkimit të shenjave në domenin e *letërsisë*. Venerimi i shenjave semantike në përcaktimin e përgjithshëm të letërsisë, pa dyshim, shkrin në vete *teorinë/filozofinë*. Udha e kërkimit dhe e interkomunikimit të shenjave tekstore/letrare, prek strukturën, diskursin e letërsisë, duke vënë përballë kërkimit objektin, pra novelën e Mitrush Kutelit *E madhe është gjëma e mëkatit - Tat Tanushi i Bubutimës*. Esencializimi i kërkimit, në vijën e strukturimit të novelës së Kutelit, doemos përpara Nysret Krasniqit, bëhet nga njohja dhe hulumtimi semantik. Nga *dija* e madhe mbi letërsinë hetohen pikat kryesore të *interkomunikimit/rrjetit*. Njohja e përgjithshme mbi domenin e letërsisë, tani në kërkim, i nënshtrohet leximit në të gjitha variantet. Leximi në variante, bëhet pa u shkëputur esencialisht asnjëherë nga rrjeti i shenjave letrare. Dihet se teksti letrar përbëhet nga shenjat që përherë janë të konotueshme. Kjo për Nysret Krasniqin do të bëhet edhe përcaktim i përgjithshëm i frymës ose metodës *strukturale/semantike*. Metoda strukturale e sheh tekstin letrar kryesisht të konotushëm në rrafshin e shenjave letrare. Duke qenë teksti i konotushëm në rrafshin e këtyre shenjave, fenomenet letrare, për Krasniqin, më shumë hulumtohen e shihen në interkomunikim të vazhdueshëm me kulturat e ndryshme. Nga kjo perspektivë kryesisht edhe novela e Kutelit *E madhe është gjëma e mëkatit - Tat Tanushi i Bubutimës* shihet si formë e strukturë autonome, me mundësi të mëdha interkomunikimi të kulturave të ndryshme. Kjo për N. Krasniqin prodhon edhe domenin e letërsisë, pra diskursin universal. *Ky është një proces riciklues që vazhdon pastaj me krijimtarinë, rikrijimtarinë, personalizimin, për t'u bërë dëshirë për komunikim me këtë Libër, komunikim ky që te njeriu, me dhembje për literaturën, artin e dijen, prodhon dëshirën për interpretim.* Të gjitha këto janë të dala nga *domeni i letërsisë, teksti letrar*, që për Krasniqin bëhet udhë kratilike e *kërkimit dhe hulumtimit*.

## Dija për tekstin

Sistemi i strukturimit të shenjave te novela e Kutelit *E madhe është gjëma e mëkatit*, për Nysret Krasniqin bëhet nga pjesët e brendshme të varianteve/leximit të konotacionit *estetik/letrar*. Rrjetet shpallen, ndërsa përvoja me tekstin gjithnjë shkon dhe shemb kohë e hapësira. Pra, thyhen kufijtë e skemës *kohë/hapësirë*. Duke u thyer kjo skemë, hetimi zgjatet nëpër variante të filozofisë së interpretimit. Zgjatja këtu nënkupton



dijen për interpretim e lexim, ku tema e novelës *E madhe është gjëma e mëkatit*, preket si fenomen e kulturë që nga antika, pra që nga dialogët e Platonit, veçanërisht nga ai Kratili. Duke u ndalur tek esencat e filozofisë së Kratilit, hapen rrugët e interpretimit për te novela e Kutelit. Dialogimi me filozofinë e kulturën antike, në nivel analizimi, cilësohet nga N. Krasniqi si nisje operative, si motiv për t'i parë variantet e nënvariantet brenda semantikës së shkrimit letrar: *Le të shërbejë si dritare motivimi e njohje me konceptet që i hasim në Antikë, të cilat do t'i gjejmë edhe si variante letrare tek autori ynë, pra duke e nënkuptuar Kratilin e Platonit, në rrafshin filozofik si invariant të novelës E madhe është gjëma e mëkatit - Tat Tanushi i Bubutimës. Le ta interpretojmë këtë tekst me zërin e Kratilit, që nuk buçet duke kërkuar këmbëngulje, por e sheh gjuhën si pjellë të mendimit/vetëdijes.*

Të themi kushtimisht, arki-kultura e filozofia tanimë në rrafsh të interpretimit bëhet zhvendosje në pikat kyçe të hulumtimit. Mbi natyrshmërinë e komunikimit të teksteve letrare, të kulturave të ndryshme, sintetizimi gjithnjë do të thellohet, për t'u vështruar deri te lënda *gjuhësore/kuptimore*. Krejt teoria e kuptimeve të emrave, e nxjerrë nga Kratili do t'i mbarështohet filozofisë së *kërkimit/kuptimit* gjatë novelës së Kutelit *E madhe është gjëma e mëkatit*. Mënyra e trajtimit të emrave konvencionalë e natyralë, pra emër i motivuar dhe i pamotivuar, do të merren nga N. Krasniqi si nocione e figura të diskursit letrar të gjuhës letrare: *Kjo filozofi, pa dyshim, të çon në pranimin e emërtimit të motivueshëm, lejon figuracionin, gjë që del në terren të meditimit, të metafizikës.* Gjeneza e emrave, e argumentuar nga filozofia e Kratilit, tani në gjuhën e shenjave të kërkuara të *eidosit*, nënkupton hyrjen në rrafsh të arki-gjenezës *filozofike/figurative* edhe të problemit trupit/shpirtit, nëpërmjet së cilave Krasniqi gradualisht heton gjuhën e tekstit, idenë e tekstit: *E madhe është gjëma e mëkatit*. Kjo edhe do të reflektohet në interpretimin e Krasniqit, duke u bërë dije e ndërdije e madhe, karshi domenit të filozofisë së tekstit letrar. Duke qenë e cilësuar dija mbi tekstin, së pari si lëndë gjuhësore, gjuhë e cila kur kalon në tekstin letrar, pra në gjuhën e fiksionit, bëhet gjuhë e figurës, gjuhë e fenomenit, e motivuar deri në skaj. Andaj, hetimi i thellë i lojës me *emra/figura* në sistemin brendatekstor, thekson modelin e veçantë të vetë interpretimit e analizimit. Kodi gjuhësor për Nysret Krasniqin kryqëzon shumë mendime rreth *tekstit/teksteve*.

*(Shkrim i shkëputur nga studim i gjatë)*

Venerim

# Paradoksi kulturor kosovar

Astrit VELIQI

Kultura është shpirti i një kombi, pasuri qytetare e shpirtërore e tij. Si e tillë kultura është konspiracion që e artikulon identitetin dhe lashtësinë edhe në skenën ndërkombëtare. Andaj, kjo pasuri – trashëgimi që duhet ruajtur me xhelozi e dashuri, nuk mund të shitet e as të blihet, por ajo ruhet, kultivohet e pasurohet vetëm me punë e sakrificë. Ky proces kulturor sentitizohet dhe haset kudo, si: në bisedë, qëndrim, imazh, komunikim, ecje, etj. Me një fjalë kultura është art, edukatë që nuk konsumohet, por hap pas hapi fitohet e bëhet ego personale e shoqërore. Pra, kjo dukuri shpirtërore është pasuri që i përket lashtësisë-trashëgimisë dhe të sotmes, gjegjësisht të ardhmes.

### Kultura kosovare 10 vite pas

Ku është kultura 10 vite pas, në Republikën e Kosovës? Mjafton të shikosh institucionet e kulturës, duke nisur me teatrin, filmin, kinematografinë, sportin, librin e shumë të tjera dhe shumë lehtë mund të spikasësh epilogun e dhimbshëm. Dhjetë vjet pas lufte, niveli kulturor është në kolaps të vërtetë. Shtrohet pyetja, pse ndodh kjo? Arsyet janë të shumta, por mendoj se fajtori qenësor në këtë mes është faktori njeri. Bartësit e institucioneve gjegjëse i udhëheqin sektorët kulturorë pa menduar gjatë, duke kujtuar se kultura është biznes dhe se 'hajt ta nëpërkëmbim'. Ky veprim mund të bëhet edhe lehtë, por përgjegjësit duhen vënë para drejtësisë, ngase kultura e një populli është pasuria më e madhe që ka, në këtë rast, Kosova. Prandaj, personat e pandërgjegjshëm nuk e kanë vendin në institucionet e kulturës dhe pikërisht ky sensacion i tyre kundër të mirës e riprodhon të keqen, atë që ne po e emërtojmë pseudokulturë. Kjo krizë shpirtërore, por edhe ekonomike, reflekton degjenerimin, kundërthënien dhe pseudokulturën në veçanti.



Ministrat e kulturës, në vija lineare, që nga paslufta, në këtë decenie kanë qenë Esat Brajshori, Astrit Haraqia, Skender Hyseni dhe i fundit Valton Beqiri. Këta të parët nuk kanë bërë asgjë më shumë e as më pak se: keqmenaxhim, parregullsi, projekte të lëna në rrugë, projektligje të miratuara etj.

Me një fjalë, Ministria e Kulturës, për një kohë të gjatë, ka qenë si të themi çerdhe e atyre të cilët nuk e kanë ditur mirë se çdo të thotë fenomeni "kulturë". Ministria nën udhëheqjen e Brajshorit nuk e ka pasur nivelin e duhur kulturor, ngase siç dihet në të ka pasur shumë parregullsi e probleme të trashëguara nga e kaluara. Kurse fat më të keq Ministria e Kulturës ka pasur edhe nën udhëheqjen e Haraqisë, ku siç dihet ka përjetuar krizën dhe aferat e shoubizneseve e televizioneve kudo, madje edhe në Shqipëri, duke lënë në mëshirë të fatit shumë sektorë kulturorë, si sportin, rininë, librin, teatrin e shumë probleme të tjera. Kurse ministri Hyseni, i cili nuk qëndroi gjatë në këtë post, nuk bëri ndonjë mrekulli siç pati planifikuar. Ndërsa i fundit tash, që po udhëheq Ministrinë e Kulturës në Kosovë, është profesor Valton Beqiri, i cili për dallim nga të tjerët së paku është me profesion të spikatur intelektual e kulturor. Edhe pse po mundohet të vërë në plan të parë kulturën dhe botën e saj, megjithatë, e ka shumë të vështirë për ta vënë në binarët e duhur.

### Kultura dhe shpirti i saj

Në të kaluarën, gjendja kulturore, marrë në përgjithësi, nuk ka qenë në nivelin e duhur, për të mos thënë absurde, ngase politikat e shumta kulturore që janë ndërmarrë, në shumë



raste, nuk kanë gjetur zbatim real në rrafshin praktik të saj. Kultura, si dukuri shpirtërore, është variabël i fuqishëm nacional, që e reflekton çdo gjë që ka të bëjë më qenien humane, shpirtërore dhe traditën e popullit. Andaj po qe se i bëjmë një tipizim më të gjerë teorik sferave më të ndjeshme, që si të themi janë boshti ku nisin aktivitetet kulturore dhe natyrisht janë vetë bota e ngushtë e kulturës, shohim se gjendja e shumë sektorëve lë shumë për të dëshiruar.


Bota e artit, si nocion, është e gjerë, ngase përfaqëson mendime e rryma nga më të ndryshmet, andaj statusi i artit në Kosovë, ballafaqohet me shumë trysni, probleme dhe ambiente jo të këndshme kulturore. Ka mjaft shembuj, fatkeqësisht të keq, që nuk dua t'i përmend, që pa dashje na sjellin deri te një mendim jo i mirë për gjendjen e asaj që nënkuptohet si vlerë, pasi në shumë raste antivlera e përmbys vlerën. Iu mbetet institucioneve të vendit që me masa konkrete, duke bërë politika të fuqishme, ta ndryshojnë këtë resor shumë të fuqishëm të shoqërisë sonë. Duke investuar në kulturë, ne, natyrisht, do të investojmë në të ardhmen tonë dhe në perspektivën evropiane. Ngase kultura dhe shpirti i saj është sfera më përfaqësuese e një populli, andaj ne duhet ta mbrojmë, kultivojmë dhe pasurojmë brez pas brezi. Në të kundërtën, epilogu do të jetë tragjik: do të humbasim identitetin tonë dhe vlerën më të madhe nacionale të trashëgimisë sonë. ■

Një kujtim për poetin Tahir Desku

# Në rrahun e shkretuar

Arben VESELI

Në një natë të errët kosove, në një rrugë theqafas, fati e zuri në grackë poetin Tahir Desku. Lajm i keq ishte ai: Tahir Desku hoqi shpirtin i vetmuar në një leqe të Kosovës! Ai s'do të duhej të vdiste kaq i vetmuar. Vdekja e tij shkroi vargun e fundit në poezinë "Kur poeti kthehet në atdhe". "Nuk jam veç poeti, por edhe heroi i tij" - do t'i ketë thënë ai natës së zezë që e mori. Si askujt tjetër, atij i qëndronte bukur hija e shmangur e trupit nga shpirti. Në qenien e tij kishte një dyzim heronjsh lirikë që namin e kishin më të madh se njëqind epika. E kishte dashur Kosovën deri në vdekje dhe për të kishte hequr shpirtin si të ishte një leckë. Në rrahun e shkretuar intelektual dhe atdhetar të Kosovës kishte qëndruar si një lis i vetmuar, por edhe atëherë duke ua ngjitur gazin "kallauzëve të rremë" që pretendonin të ishin baballarët e kombit. S'e pati për "turp" t'i gjendej Kosovës afër edhe atëherë kur atë u desh ta mbulonte me shtat nga sëpatat dhe thikat serbe. Edhe pse ishte poet skofiar, nuk çau kokën për dilemën lasgushiane: poet apo pushkatar (...)




Si "plëngprishës" në kujtesën e alesë letrare, ai ndoshta gjithnjë e më pak do të përmendet, por nuk do ta zërë assesi harrimi i jehut të këngëve të tij, që u bënë himne të një populli dhe të një historie të përgjakshme. Kështu ndoshta edhe mund të ndodhë, sepse ai me kohë u bë pjesë e proveniencës së atyre që patriotizmin e bënin me të bëma. Ishte bërë pjesë e një lufte të çuditshme, në të cilën kishin shkuar ata që do të duhej të shkonin, ndërkaq e kishin shtrirë qafën e nënshtrimit ata që do të duhej të ishin të parët. Shpesh thoshte se i ishte bashkuar UÇK-së, sepse luftën e kishte parë si diçka të domosdoshme. "Liria është art i rëndë i surealizmit dhe gjuha e saj imagjinatë tjetër fare, për të cilën po bëheshim fli", - thoshte ai, si për të dëshiruar ta përkufizonte mendimin e tij për luftën. Shkuam në luftë, deshi të thoshte Tahir Desku, nga frika se do ta humbasim logjikën për vetveten para fatumit historik. Me gjasë, që t'i shpërfaqnim edhe njëherë dhembjet e vjetra të kohës së re. Lufta ishte ngrehë e imagjinatës, prej nga mund ta shihnim jetën me përbuzje. Mospërfilljen e saj nga aty e tundonin tërmetet e shpirtrave tanë të flashkët. Kosova dhe liria qenë Olimp i papushtuar, drejt të cilit na ngashënjente dashuria atdhetare. Ishte eliksir i shpikur për t'i bërë lak trishtimit. Vend për të mos vdekur, ndoshta varr, të cilit i druanim për shkak të vetmisë dhe harrimit. Ata që e harruan atë, edhe pse nuk duhej, qysh prej mbarimit të luftës e deri kur u shtri në tabut pranë shtratit të varrit, do të duhej ta përkujtonin se Tahir Desku ishte dhe mbetet kronisti më i mirë që e përjetësoi lavdinë e luftës dhe heronjve të saj. Ai ishte dhe do të mbetet njëri nga protagonistët historikë nga më të pafajshmit, më të sinqertit dhe më të keqkuptuarit e historisë më të re shqiptare. ■

# Të falem me shpirtin plot dashuri

Valmira PECI

## Ilah

S´ka të adhuruar
Tjetër
Të merituar
Pos Teje

Mëshirues
Të falem me shpirtin plot dashuri
Mëshirëbërës
Të lutem për dashuritë e mia

## Po

Sa vjet ka fjetur vajza
Me Orën plakë mbi sy

Sa hapa Purgatori eci
Me parajsën danteske në kokë

Pas gjumit të plogësht mesjetar
Në shtratin e Rilindjes fërkon sytë

Buzë lumit italian lan flokët zonjusha
Uji botën prek

## Ora

Flakë pishtari themeleve të shtëpisë
Lundron imazhi yt
Orë e Mirë

E rinimit të babës,
E kënaqësisë amënore
E vatrës së nipit…

Orë e Bardhë

Fascinon përrallen e mitin
Largon mallin
Orë e Madhe

Amshueshmërisht me mua

URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI URTI

Aty ku çmohet urtësia - ka të dijshëm, aty ku çmohet guximi - ka trima. Aty ku nuk çmohet asgjë - nuk ka asgjë.

*(Aristoteli 384-332 p.e.r, dijetar antik grek)*

Hapja e një shkolle do të thotë mbyllja e një burgu.

*(Viktor Hygo 1802-1885, shkrimtar francez)*

Optimist është njeriu që sheh zgjidhje në çdo katastrofë. Pesimist është ai që e sheh katastrofën në çdo zgjidhje.

*(Mark Tuen (1835-1910, shkrimtar amerikan)*

Problemet e rëndësishme, me të cilat ballafaqohemi, nuk mund të zgjidhen me nivelin e njëjtë të të menduarit që i ka krijuar ato.

*(Albert Ajnshtajn 1879-1955, shkencëtar çifut)*

Të gjithë japin këshilla falas, sepse askush nuk i blen.

*(Zhorzh Sand 1804-1876, shkrimtar francez)*

Politikanët gjithkund janë të njëjtë. Ata premtojnë se do të ndërtojnë ura atje ku nuk ka lumë.

*(Nikita Hrushov 1894-1971, lider komunist sovjetik)*

Nëntëdhjetë për qind e politikanëve i japin namin e keq dhjetë përqindëshit.

*(Henry Kissinger 1928-......, diplomat amerikan)*



No Comment!

# Angina


**Angina është një simptomë që karakterizohet me dhimbje në regjionin e kafazit të kraharorit si pasojë e mosfurnizimit të mjaftueshëm me oksigjen të indit muskulor të zemrës**

Iliriana ALLOQI &
Bernard TAHIRBEGOLLI

Dhembja në gjoks është simptomë shumë e shpeshtë që e përjetojnë shumë njerëz gjatë jetës së tyre. Ajo është rezultat i shumë shkaqeve dhe mund të alarmojë për sëmundje serioze e madje kërcënuese për jetë. Nga ana tjetër, ajo mund të jetë pasojë e çrregullimeve që nuk janë kërcënuese për jetë, por që e bën pacientin të paaftë për shkak të shqetësimit, frikës dhe jokomoditetit që ndien.

Dhembja e zemrës është formë e veçantë e dhembjes që projektohet në një regjion të caktuar. Ajo është sipërfaqësore. Ka prejardhje nga regjioni ku ka një disproporcion mes furnizimit me oksigjen të indit të zemrës dhe nevojave të tij për këtë element. Prejardhja e kësaj dhembje është nga arteroskleroza, spazma e enëve të gjakut të zemrës, trombozës së këtyre enëve, etj. Sëmundja e arterieve koronare prin në mesin e shkaqeve të vdekjes në vendet e zhvilluara. Studimet e ndryshme kanë treguar se ndër shkaqet e shpeshta të dhembjes së kraharorit përfshihen çrregullimet gastrointestinale, muskuloskeletale, pulmonale dhe ato të natyrës psikologjike, si dhe shkaqet e tjera kardiake. Vlerësohet se parregullsitë muskuloskeletale janë të pranishme te 13 deri 20% e pacientëve me dhimbje gjoksi. Rëndësi më të madhe ka dhimbja me origjinë nga ezofagu, e cila shpeshherë vështirë dallohet nga angina. Arsyeja e konfuzionit mes dhimbjes në gjoks, të shkaktuar nga ezofagu dhe dhimbjes në zemër nuk qëndron vetëm në afërsinë e këtyre strukturave, por edhe në faktin se ezofagu dhe zemra kanë rrugë nervore të ngjashme përgjegjëse për ndjesinë e dhimbjes. Ndjesia e dhembjes tek angina shprehet në dorën e majtë, krahun e majtë, kafazin e kraharorit, posaçërisht rreth dërrasës së kraharorit, në qafë, në nofullën e poshtme, por jo rrallë kalon edhe në anën e djathtë. Dallojmë anginën stabile dhe atë jo stabile. Angina stabile, ose e qëndrueshme, diagnostikohet atëherë kur janë të pranishme disa kritere, gjegjësisht simptoma. Dhimbja e provokuar me sforcim është kriteri i artë te kjo anginë. Kjo sforcohet me vazhdimin e aktivitetit dhe pushon në qoftë se pushon aktiviteti, gjegjësisht qetësohet personi nga stimuli që e ka shkaktuar atë sforcim fizik ose psikik. Shkaktarë të tjerë që provokojnë ose predispozojnë zhvillimin e anginës janë edhe sëmundjet valvulare të aortës, kardiomiopatia hipertrofike, spazma e arterieve koronare, faktorët trashëgues etj. Nuk duhet harruar edhe roli i madh që kanë në shfaqjen e anginës edhe pirja e duhanit, hipertensioni dhe hiperlipidemia, gjegjësisht rritja e një fraksioni të yndyrave në gjak. Kjo lloj angine, ose këto ankesa që e përcjellin këtë lloj angine, përveç se lirohen me pushim-qetësim, ato pushojnë ose qetësohen edhe me marrjen e një tablete të nitrateve nën gjuhë. Në qoftë se kjo nuk e liron dhembjen mund të merret edhe e dyta pas pesë minutave dhe po qe se as me atë nuk qetësohen dhimbjet, atëherë destinacioni është te mjeku. Duhet të kihet parasysh se këto nitrate me përdorim të tepërt mund të shkaktojnë efekte të tolerancës në organizëm. Preferohet që të gjithë ata që marrin këtë terapi të kujdesen për një periudhë "pushimi" pa nitrate, përafërsisht rreth 6-8 orë në ditë.



**Këshilla për pacientët me anginë stabile**

➥ *Mos pini duhan!*

➥ *Kujdesuni të mbani peshën ideale të trupit tuaj!*

➥ *Bëni ushtrime të rregullta fizike (jo sforcime të menjëhershme por ecje, 3-4 orë në javë. Mos nguroni sepse ngarkesat e tilla ndikojnë që zemra të zhvillojë enë të reja gjaku që do ta furnizojnë më mirë me gjak)!*

➥ *Mos bëni përpjekje të rënda për ushtrime apo punë fizike!*

➥ *Shmanguni ushtrimeve pas ushqimeve të tepërta dhe në temperatura të larta!*

➥ *Përdorni nitratet nën gjuhë para një aktiviteti që mund t'ju provokojë zhvillimin e anginës!*

Angina jo stabile është ajo lloj angine që paraqitet kur personi është në qetësi dhe nuk pushon edhe nëse personi shtrihet ose qetësohet dhe për dallim nga angina stabile, e cila ka një atak të shkurtër, te kjo ataku, gjegjësisht dhembja, zgjat më shumë. Për shkak të patofiziologjisë së ngjashme me infarktin e miokardit në terminologjinë bashkëkohore po i jepet përparësi termit 'sindroma akute koronare' për t'i përshkruar këto simptoma që janë rrjedhojë e anginës jo stabile. Perzistimi më gjatë i këtyre shqetësimeve, që rrjedhin nga angina jo stabile, mund të përparojë dhe të kalojë në një shkallë kur zemra nuk mund të rezistojë më pa oksigjen dhe fillon e zhvillohet infarkti i miokardit, gjegjësisht muskulit të zemrës. Për shkak të rrezikut për zhvillimin e infarktit të miokardit është e rëndësishme që këta pacientë të drejtohen sa më shpejt te spitali më i afërt dhe të mundohen që gjatë kësaj kohe të qëndrojnë shtrirë. Dërgimi i shpejtë e këtyre personave në spital dhe intervenimi i duhur mund ta ulë menjëherë rrezikun e zhvillimit të infarktit të miokardit për rreth 60%. ■

Intervistë me futbollistin shqiptar Besart Berisha

# Besart Berisha ëndërron të luajë për Kosovën

**Sulmuesi i Kombëtares Shqiptare, Besart Berisha, ëndërron të luajë për Kosovën, por njëkohësisht ai është për një kombëtare të përbashkët, ngase ajo do të ishte shumë më e fortë**





**Alban BILALLI**

Besart Berisha (i lindur më 29 korrik, 1985 në Prishtinë) është një futbollist shqiptar nga Kosova që luan për Kombëtaren Shqiptare të futbollit. Ai ka lindur në Kosovë, por qysh fëmijë është detyruar të largohet për shkak të luftës dhe të vendoset në Gjermani. Atje, prej vitit 1994 deri në vitin 2004, Berisha luan me ekipet e të rinjve në klubet Berliner VB49, BFC Dynamo, TSV Lichtenberg dhe Tennis Borussia Berlin. Në vitin 2004 ai filloi karrierën e tij profesioniste kur nënshkroi për klubin Hamburger SV të Hamburgut. Mirëpo, për shkak të problemeve me leje qëndrimin në Gjermani, ai u huazua po atë vit te dy klube të elitës daneze të futbollit, Aalborg Boldspilklub dhe AC Horsens, ku kaloi me sukses dy sezone. Gjatë verës së vitit 2006, ai kthehet në Gjermani dhe nënshkruan kontratë të re katërvjeçare me Hamburger SV. Pas lojës së mirë që shfaqi në takimin Angli - Shqipëri, në vitin 2007, ai u transferua në klubin anglez Burnley. Pas Barnleyet, ai huazohet në skuadrën daneze Horsens. Këtë verë ka nënshkruar kontratë 3 vjeçare me klubin gjerman Aremenia Bielfeld. Para se të shkonte për t'u grumbulluar me lojtarët e tjerë të Kombëtares në Tiranë, për takimin kundër Danimarkës, Berisha ishte në Prishtinë, me ç'rast revista jonë, bëri një intervistë me të.

**"PAQJA":** ***Kur keni filluar të luani për herë të parë futboll?***

**B.Berisha:** Unë jam larguar nga Kosova qysh në moshën 7 vjeçare. Sa kam qenë në Kosovë kam luajtur me shokët në rrugë dhe në shkollë. Pastaj në Gjermani, kam filluar të luaj futboll aty prej moshës 8 vjeçare.

**"PAQJA":** ***Kush e vërejti talentin e tënd?***

**B.Berisha:** Talentin tim e vërejti babai im, të cili e dua dhe e respektoj shumë. Ai është një simpatizues i madh i futbollit. Një fanatik i madh i futbollit. Ai më ka shtyrë që të merrem me futboll. E më pas u kam rënë në sy trajnerëve.

**"PAQJA":** ***Trajneri Kuzhe ju ka ftuar për ndeshjen kundër Danimarkës. Si e pritët ftesën?***

**B.Berisha:** E ndiej veten shumë mirë sepse sa herë që luaj për Shqipërinë ndihem mirë dhe mundohem ta jap maksimumin tim.

**"PAQJA":** ***Sipas jush kush i ka "fajet" që Shqipëria është në vendin e parafundit?***

**B.Berisha:** Për t'u kualifikuar na duhet një punë shumë e madhe. Ne nuk mund që t'i ndryshojmë gjërat brenda një nate. Duhet të jemi realistë. Për mendimin tim, barazimi me Portugalinë në Lisbonë 0-0 është një sukses shumë i madh, duke pasur parasysh lojtarët momentalë që ka Shqipëria.

**"PAQJA":** ***Çfarë mendoni për trajnerin Josip Kuzhe dhe cili ishte trajneri më i mirë në Kombëtare prej se jeni pjesë e Kombëtares?***

**B.Berisha:** Prej tri viteve që jam në Kombëtare, me trajnerin kroat Oto Bariq kam pasur më së shumti bashkëpunim. Bariqit i ka pëlqyer loja ime. Në formacionin e tij kam pasur mundësi që të luaj në çdo pozicion. Trajnerët e tjerë kanë pasur një dallim prej tij. Ata kanë kërkuar një gjë prej lojtarit në fushë dhe ty të është dashur t'i përmbahesh asaj taktike dhe disipline që ai ka kërkuar. Sa i përket Kuzhes, me të kam pasur vetëm dy lojë. Shpresoj se do të kemi bashkëpunim të mirë. Pa marrë parasysh tra-





jnerin, unë në çdo ndeshje jap maksimumin tim.

**"PAQJA"**: ***Cilin futbollist shqiptar e simpatizoni?***

**B.Berisha:** Fadil Vokrrin e kam simpatizuar shumë. Vokrri është dalluar prej të tjerëve. Në Kombëtare ka shumë lojtarë. Cana ka arritur shumë, sepse ai ka luajtur disa ndeshje në Ligën e Kampioneve. Pastaj Skela, Lala etj. Në Kosovë, tani për tani, nga lojtarët aktivë të Superligës, më pëlqen Enis Fetahu. Diego Forlan është futbollisti i huaj që pëlqej më së shumti, ngase loja ime i përngjan lojës së tij.

**"PAQJA"**: ***Pritet anëtarësimi i Kosovës në UEFA. A do të luani për Kosovën?***

**B.Berisha:** Për mua është njëlloj, si të luaj për Kosovën, si për Shqipërinë. Për mua është një komb. Më mirë do të ishte që të kemi një Kombëtare. Tani luaj për Shqipërinë. Unë kam lindur në Kosovë dhe do të luaj për Kosovën po qe se kam mundësi. Pse jo? Kosova është atdheu im. Unë kam lindur në tokën e saj. Ëndërroj të luaj për Kosovën.

**"PAQJA"**: ***Besart ju jashtë fushës së gjelbër njiheni edhe si njeri human. Ju keni dhënë edhe bursa për studentë të Universitetit të Prishtinës?***

**B.Berisha:** Po unë mundohem t'i ndihmoj të tjerët aq sa mundem. Disa studentëve unë u kam ndarë bursa për studime dhe do të vazhdoj me një gjë të tillë sa të kem mundësi.

**"PAQJA"**: ***Po ashtu ju jeni njeri nga sponsorët e klubit futbollistik "Paqja"?***

**B.Berisha:** Unë mundohem që këtë klub ta ndihmoj me fanella, topa dhe gjëra të tjera të nevojshme. Unë e di se çfarë kushtesh kanë sportistët në Kosovë, prandaj mundohem t'i ndihmoj me aq sa kam mundësi.

**"PAQJA"**: ***Ju faleminderit për kohën që ndatë për intervistë. Njëkohësisht në emrin tim dhe të simpatizantëve të tu, të uroj suksese në të ardhmen.***

**B.Berisha:** Unë luaj për simpatizuesit. Ata janë lojtari i 12 për mua. Pa ta futbolli nuk ka hijeshi. Ata më japin forcë, ata më bëjnë që ta jap maksimumin tim. Unë i përshëndes të gjithë simpatizuesit e mi dhe i falënderoj përzemërsisht për përkrahjen që më kanë dhënë gjatë gjithë karrierës sime. ■

# Refuzon të luaj në Ramazan

**Ibrahim Jaaber, basketbollisti amerikan me nënshtetësi bullgare, ka refuzuar të paraqitet në Kampionatin Evropian në Poloni për të respektuar muajin e shenjtë të Ramazanit. Vendimi i Ibrahim Jaaberit erdhi për arsye se ai dëshiron që t'i përkushtohet maksimalisht këtij muaji dhe se agjërimi nga lindja deri në perëndimin e diellit mund të ndikojë shumë në paraqitjet e sportistëve dhe të dëmtojë klubet e tyre**

Basketbollisti më i mirë i Bullgarisë, Ibrahim Jaaber me nënshtetësi bullgare ka refuzuar të luajë me Bullgarinë në Kampionatin Evropian që filloi më 7 shtator dhe që përfundon më 20 shtator. Polonia është vendi organizator.

Rasti i Jaaberit është i veçantë, ngase shumë sportistë të tjerë nuk agjërojnë vetëm që të kenë mundësi që të luajnë sa më mirë për klubet e tyre. Futbollistët e Barcelonës (Ture, Abidal, Keita) me përkatësi muslimane nuk agjërojnë, sikurse as ata të Real Madridit (Benzama, Diarra). Rast i veçantë është edhe futbollisti i Interit, ganezi Sulej Muntari i cili edhe agjëron, edhe luan.


"Arsyeja pse nuk luaj është muaji i madhërishëm i Ramazanit"- ka thënë Jaaber.

Jaaber ishte pikëshënuesi më i mirë i Bullgarisë gjatë kualifikimeve për në kampionatin evropian të basketbollit në Poloni, me mesatare prej 16 pikëve, 5.1 kërcimeve dhe 3.5 asistimeve, duke qenë njëri nga basketbollistët kryesor.

Mungesa e tij ka detyruar selektorin e Bullgarisë, Pini Gershon, të zgjedhë mes David Moss, Andre Owens dhe EJ Rowland. Të gjithë basketbollistët në konkurrencë për këtë pozitë janë amerikanë të natyralizuar. Refuzimi i Jaaberit për pjesëmarrje në kampionatin evropian është goditje e rëndë për Bullgarinë. Jaaber udhëhoqi ekipin në kualifikime duke mposhtur, përveç të tjerash, edhe Italinë dhe duke i pamundësuar Azzurrëve të paraqiten në garë.



# FJALËKRYQ KLASIK



**HORIZONTALISHT:**

1.Basketbollisti në foto. 8. Copë kartoni, pëlhure, lëkure etj., e prerë në trajta e përmasa të ndryshme, e vizatuar ose e përkulur në trajtën e një fytyre njeriu (sh.shq.). 14. Mbulimet e të metave me ç'kemi në dorë. 15. Masë e sipërfaqes së tokës, e barabartë me njëqind arë ose me dhjetëmijë metra katrorë. 16. Sezon sportiv. 17. Fatkeqësi. 18. Tartar. 19. Krah (ang.). 20. Emision për femrat në KTV. 21. Association of Real Estate Taxpayers (shkurt). 22. Rajon gjuhësor. 24. Ish-sekretari i OKB-së, Kofi. 25. Njeri i akullit. 26. Ai që sajon fjalëkryqe. 28. Njësi matjeje e sipërfaqes së tokës, e barabartë me 100 metra katrorë. 29. Mbretëresha e famshme ilire. 31. Emër mashkulli (i urtë). 33. Nistoret e dëshmorit të kombit, Krasniqi. 34. Kaliumi. 35. Emër mashkulli shqiptar. 36. Emnaku i Raifes. 38. Organizata Tregtare (shkurt). 40 Abu Nidal Organization (shkurt). 41. Mangët. 43. Burim i hapur molekular për strukturën e proteinave. 15.Në gjuhën e paraardhësve tanë. 49. Tërësia e qimeve të gjata që mbulojnë lëkurën e bagëtive të imëta. 51. Ai që nuk di ç'është frika. 53. Që ka tipare të çmueshme e të pëlqyeshme. 54. Delja e zezë. 55. Paralelogram me brinjë të barabarta, me dy kënde të ngushta e dy të gjera. 57. Pjesa e majtë a e djathtë e një sendi ose e një vendi. 58. Dhënie e votës. 59. Bërja e anketës. 61. Vend në Ulqin. 62. Pjesë e palëvizshme e motorit. 63. Kësula burrash ose grash zakonisht prej stofi e me strehë (sh.shq.). 64. Tërësia. 65. Që i përmbahet një besimi fetar.

**VERTIKALISHT:**

1. Më vonë. 2. Arpunueset. 3. Bashkimet. 4. Baltë e qullët, gjanë. 5. Hyjni romake e dashurisë. 6. Zotëri (ang.). 7. Oliver Tuist. 8. E lodh dikë sa e lë gati pa frymë, e bëj sa t`i bjerë të fikët. 9. Xhamia e njohur në Jerusalemin e sotëm, Al... 10. Sezoni. 11. Aktore dhe këngëtare e njohur nga Venezuela. 12. Shkel e shko. 13. Njëri nga tre filmat që morën nga 11 oskarë. 15. Banjë allaturka, banjë turke. 17. Vend i posaçëm ku tregtohet një lloj malli. 19. Metal i rrallë e i çmuar. 22. Shahisti i njohur rus, Karpov. 23. Zog këngëtar, pak më i madh se harabeli, me ngjyrë të përhime e me pika të errëta, që rri arave. 26. Lloj alkini. 27. Fletë e shtypur a broshurë e vogël, që përmban thirrje, parulla e çështje politike të kohës dhe që ngjitet në mure ose shpërndahet zakonisht fshehurazi. 30. Ndërtim prej druri guri ose metali, që lidh dy anë të një lumi. 32. Cipë e hollë në sy, perde. 34. Dallim shumë i madh ndërmjet dy a më shumë sendeve. 37. Mbledhje pullash poste e pullash të tjera për koleksion. 39. Qyteti më i madh në Kanada - kryeqyteti provincial i Ontarios. 42. Shumë i pastër, i kthjellët, i kulluar. 44. Emërtimi i përgjithshëm për disa lloje kandrrash të vogla parazite (sh.shq.). 46. Aktorja e njohur shqiptare, Besa. 47. Mosha e re e jetës së njeriut në mes të fëmijërisë dhe të pjekurisë. 48. Irish Republican Army (shkurt.). 50. Faculetat. 52. Ngela. 54. Vend turistik në Shqipëri, afër Kavajës. 56. Interactive Tree Of Life (shkurt). 58. Nxehtësi e madhe. 60. Farae gjelit në vezë. 61. Gaz (ang.). 63. Kenia. 65. Grup gjaku.

*Autor: Agim GASHI*